



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal
Affairs

STRATEGJIA PËR MIGRIM

2021-2025

PËRMBAJTJA:

- 1.1. Përmbledhje Ekzekutive
- 1.2. Hyrja
- 1.3. Metodologjia
- 1.4. Historiku (sfondi)
- 1.5. Objektivat
- 1.6. Shtojcat

Shkurtesat

AFIS	Sistemi i Identifikimit të Automatizuar të Gjurmëve të Gishtërinjve
AKAZH	Agjencia e Kosovës për Avokim dhe Zhvillim
APRK	Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës
AQM	Autoriteti Qeveritar për Migrim
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATRC	Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim
BE	Bashkimi Evropian
BK	Buxheti i Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
CARITAS i Zvicrës	Organizata Ndërkombëtare Zvicrane që ofron ndihmë në fushën e riintegritit në Kosovë
CRPK	Programi për të Drejtat Civile në Kosovë
DHTQN	Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore
DIMAK	Pika Informative Gjermane për Migracion, Trajnim Profesional dhe Karrierë
DMH	Drejtoria për Migrim dhe të Huaj
DPD	Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion
DRPRIH	Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve
DRC	Këshilli Danez për Refugjatë
EURODAC	Baza Evropiane e të Dhënave të Daktiloskopisë së Azilit
EUROSTAT	Zyra Statistike e Bashkimit Evropian
FRONTEX	Agjencia Evropiane e Gardës Kufitare dhe Rojet Bregdetare
GIZ	Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GDISC	Konferenca e Drejtorëve të Përgjithshëm të Shërbimeve të Imigracionit
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracion
IPA	Instrumenti për Para-Anëtarësim
IVO	Informacioni i Vendit të Originës
KA	Kosto Administrative
KB	Kombet e Bashkuara
KE	Komisioni Evropian
KKM	Koordinatori Kombëtar për Migracion
KKR	Komisioni Kombëtar për Refugjatët
KKSP	Këshillat Komunal për Siguri Publike
MARRI	Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

MIMAK	Projekti 'Forcimi i Autoriteteve të Menaxhimit të Migrimit në Kosovë'
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
ME	Ministria e Ekonomisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PZM	Profili i Zgjeruar i Migrimit
QKRVT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
SDC	Bashkëpunimi Zvicran për Zhvillim
SIMM	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Migracionit
SIVK	Sistemi Informativ i Vizave të Kosovës
SS	Sekretariati për Strategjitë
SHJR	Shërbimi i Jezuitëve për Refugjatët
UA	Udhëzimi Administrativ
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Emergjencat e Fëmijëve
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik

1.1 Përmbledhja Ekzekutive

Strategjia për Migrim 2021-2025 Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Migrim 2021-2025 (në tekstin e më tutjeshëm Plani i Veprimit) reflekton prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për menaxhimin e migrimit në vend përmes mekanizmave institucional. Kjo Strategji gjithashtu reflekton zotimet e Qeverisë për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e migrimit dhe obligimet që rrjedhin nga procesi i integritimit Evropian, respektivisht për zbatimin e obligimeve që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim-Asociim në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Objektivat strategjike dhe ato specifike janë përcaktuar pas një procesi të konsultimit me të gjithë akterët e brendshëm institucional dhe atyre të jashtëm nga shoqëria civile, dhe partnerët ndërkombëtar. Strategjia për Migrim 2021-2025 gjithashtu është bazuar në analizat dhe rekomandimet në kuadër të Profileve të Lehta dhe Zgjeruara të Migrimit, të zhvilluara nga Autoriteti Qeveritar për Migrim. Poashtu, në kuadër të Strategjisë janë reflektuar objektiva dhe masa të cilat dalin si rezultat i politikave dhe iniciativave në nivel rajonal, evropian dhe global, në rradhë të parë nga Pakti i BE-së për Migrimin dhe Azilin, Pakti Global për Migrimin dhe Pakti Global për Refugjatë.

Ky dokument strategjik ndahet në dy pjesë: Strategjia për Migrim dhe Plani i Veprimit, i cili përmban objektivat strategjike, ato specifike si dhe aktivitetet që planifikohen të përmbushen në periudhën pesë vjeçare 2021 – 2025. Objektivat strategjike dhe specifike, si dhe aktivitetet janë të paraqitura detajisht në Planin e Veprimit, i cili po ashtu përmban institucionet përgjegjëse, koston buxhetore dhe burime e financimit si dhe indikatorë të matshëm dhe konkret. Me qëllim të arritjes së qëllimit kryesor në funksion të fuqizimit të menaxhimit të migrimit, Strategjia për Migrim 2021-2025 vendoset mbi këto shtylla, përkatësisht objektiva strategjike:

Objektivi strategjik 1: Menaxhimi i migrimit të rregullt;
Objektivi strategjik 2: Garantimi i migrimit të sigurt, të organizuar dhe të rregullt;
Objektivi strategjik 3: Menaxhimi i Migrimit të brendshëm;
Objektivi strategjik 4: Avancimi në fushën e menaxhimit të migrimit dhe sistemit për mbrojtje ndërkombëtare.
të Brendshëm;

Si analizë bazë në hartimin e kësaj strategjie, janë marr parasysh vlerësimi¹ i zbatimit të Strategjisë për Migrim 2013-2018, vlerësimi i zbatimit të Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar 2018-2022 si dhe analizat e bëra në dokumentin e Profilit të Zgjeruar të Migrimit,

¹ Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë Shtetërore për Migrim 2013-2018 është pregaditur nga Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga Bashkimi Evropian (shih Aneks IV).

Profileve të Lehta të Migrimit si dhe hulumtimeve të ndryshme të drejtuara dhe të hartuara nga AQM-ja.

Në Strategjinë për Migrim 2021-2025 rekomandohen veprime konkrete dhe masa ligjore, strategjike dhe institucionale me qëllim të adresimit të sfidave të identifikuar dhe përmirësimit të gjendjes në menaxhimin efikas të migrimit. Në këtë drejtim, janë paraparë veprime në funksion të fuqizimit të institucioneve shtetërore përgjegjëse për menaxhimin e migrimit në veçanti Autoritetin Qeveritar për Migrim (AQM); krijimin dhe zhvillimin e sistemit për menaxhimin e migrimit të brendshëm; fuqizimin e sistemit për mbrojtje ndërkombëtare, garantimin e migrimit të sigurt dhe të rregullt; thellimin e bashkëpunimit rajonal dhe me organizata të specializuara ndërkombëtare, etj. Të gjitha këto veprime janë rekomanduar si rezultat i vlerësimit të situatës aktuale në vend dhe në kontekst rajonal e global, në raport me lëvizjet dhe trendet e reja migratore; analizave gjithëpërfshirëse të dokumenteve strategjike siç është Profili i Lehtë dhe i Zgjeruar i Migrimit dhe analizave tjera empirike të dalura nga hulumtimet e ndryshme të realizuara përgjatë viteve paraprake. Rrjedhimisht, adresimi i veprimeve të rekomanduara pritet të ketë ndikim pozitiv në adresimin e boshllëqeve të identifikuar në sistem, duke mundësuar njëkohësisht avancimin dhe fuqizimin e menaxhimit të migrimit si një shtyllë e rëndësishme e zhvillimit socio-ekonomik të vendit.

Strategjia për Migrim 2021-2025 është zhvilluar paralelisht me Strategjinë Kombëtare Zhvillimore 2021-2030. Në këtë drejtim, Grupi Punues i ngarkuar për hartimin e Strategjisë për Migrim 2021-2025, në vazhdimësi është konsultuar dhe koordinuar me Zyrën për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për të siguruar sinergji dhe koherencë të plotë të Strategjisë së Migrimit 2021-2025 me Strategjinë Kombëtare Zhvillimore 2021-2030.

Për më tepër, si rezultat i rishikimit të kornizës së politikave strategjike dhe me qëllim të përmirësimit të procesit të planifikimit strategjik, proces ky i udhëhequr nga Zyra për Planifikim Strategjik, Strategjia për Migrim 2021-2025 është fuzionuar me Strategjinë për Riintegrimin Personave të riatdhesuar.

Plani i Veprimit të Strategjisë së Migrimit 2021-2025 është hartuar në përputhje me Udhëzimet dhe Manualin për Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, rrjedhimisht aktivitetet e planifikuara janë në koherencë dhe në funksion të arritjes së objektivave specifike dhe strategjike të Strategjisë. Poashtu, me qëllim të ndërlikohjes së masave të planifikuara me kornizën buxhetore përkatësisht Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, Plani i Veprimit do të mbulojë fillimisht periudhën 2021-2023 dhe pritet të rishikohet gjatë vitit 2023.

1.2 Hyrje

Në vazhden e zhvillimeve gjeopolitike me konotacione të sigurisë globale dhe lëvizjeve migratore në rajon, Republika e Kosovës mund të preket gjithashtu nga këto lëvizje duke u përdorur si vend tranzit. Me këtë rast fuqizimi i bashkëpunimit ndërkuftar mes shteteve të rajonit, si dhe bashkëpunimi me vendet e origjinës, tranzitit dhe destinimit është i një rëndësie të veçantë. Gjithashtu, shkëmbimi i përvojave dhe informatave ndërmjet institucioneve dhe mekanizmave përkatës është e një rëndësie të veçantë.

Republika e Kosovës karakterizohet me një numër të madh emigrantësh, përderisa ka një popullësi relativisht të re në moshë. Sipas indikatorëve kryesorë të tregut të punës shkalla e papunësisë (15-64 vjeç) në vitin 2019 ishte 25.7 % ndërsa në vitin 2020 ishte 25.9%. Sfiduese është shkalla a lartë papunësisë së të rinjve (15-24) që kap shifrën rreth 49.1%.²Për më tepër, ndikimi i pandemisë Covid-19 në sektorin privat mund të rezultojë me humbje të vendeve të punës dhe rrjedhimisht nxitje të një vale të re të mundshme të emigrimit. Në këtë drejtim, orientimi i burimeve dhe masave adekuate me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike do të jetë prioritet kyq nga Qeveria e Republikës së Kosovës, duke adresuar kështu sanimin e dëmeve ekonomike të shkaktuar nga pandemia si dhe ndërlidhjen me politikën zhvillimore të vendit me çështjet e migrimit me synim të zgjidhjes afat-gjate të sfidave socio-ekonomik në vend si faktorë shtytës të migrimit.

Përgjatë hulumtimeve dhe zhvillimit të analizave të ndryshme, AQM ka identifikuar mungesën e qasjes strukturore në raport me migrimin e brendshëm, sidomos në raport me lëvizjen e qytetarëve nga një qytet në qytetin tjetër apo nga vendet rurale në ato urbane, duke shkaktuar vështirësi në planifikimet adekuate buxhetore të komunave në Kosovë. Në këtë drejtim, edhe pse Ligji për Vendbanimin dhe Vendqëndrim 02/L-121 i obligon qytetarët të regjistrojnë ndryshimet në vendbanim përkatësisht të regjistrohen në komunën ku janë vendosur, në praktikë shfaqen vështirësi dhe në shumicën e rasteve kjo nuk ndodh. Kjo krijon vështirësi në zhvillimin politikave publike në sektorët vital siç është arsimi, shëndetësia, çështjet sociale dhe politikën ekonomike të cilat synojnë zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik qoftë në nivel qendror, qoftë në atë lokal.

²Anketa e Fuqisë Punëtore 2020, <https://ask.rks-gov.net/media/6125/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-afp-2020.pdf>

1.3 Metodologjia

Kjo strategji është hartuar nga Grupi Punues i themeluar me vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kryesuesi i Autoritetit Qeveritar për Migrim është mandatar që të udhëheqë grupin punues për hartimin e strategjisë. Lista e anëtarëve të këtij grupi punues është në shtojcë. Hartimi i dokumentit është përkrahur nga Projekti DIMAK në kuadër të GIZ, si dhe Projekti MIMAK i financuar nga Qeveria e Zvicrës dhe implementuar nga ICMPD. Këto projekte kanë organizuar punëtori dhe takime (gjithnjë në përputhje me rekomandimet e IKSHP-së dhe vendimet e Qeverisë) me akterë të ndryshëm institucional për përcaktimin e objektivave strategjike, atyre specifike si dhe aktiviteteve/masave implementuese. Metodologjia e ndjekur në këtë proces ka përfshirë vlerësimin e zbatimit të strategjisë së kaluar për migrim 2013-2018 dhe shkallën e përmbushjes së objektivave të saj nëpërmes realizimit të aktiviteteve. Vlerësimi i zbatimit të kësaj strategjie është në shtojcën 2. Pas vlerësimit të zbatimit të strategjisë, janë identifikuar boshllëqet në plotësimin e përmbushjes së aktiviteteve të mëparshme dhe identifikimin e aktiviteteve të reja që shpjen kah përmirësimi i përgjithshëm në fushën e migrimit. Përgjatë punëtorive dhe takimeve janë diskutuar dhe dhënë vlerësime për gjendjen aktuale duke përfshirë edhe ndikimin e Covid-19, me ç'rast janë propozuar aktivitetet që do të ndihmonin arritjen e objektivave specifike dhe realizimin e atyre strategjike duke propozuar përmirësime me fokus në menaxhimin dhe qeverisjen e migrimit në përgjithësi.

Përcaktimi i objektivave strategjike, atyre specifike dhe aktiviteteve është bazuar në të dhënat, të gjeturat dhe rekomandimet nga Profili i Lehtë i Migrimit 2019. Hartimi i strategjisë ka kaluar nëpër një proces gjithëpërfshirës të konsultimeve paraprake dhe publike në përputhje me Rregulloren për standardet minimale për procesin e konsultimit publik nr.05/2016. Gjatë përcaktimit të objektivave strategjike, kujdes i veçantë i është kushtuar evitimit të dyfishimit të mundshëm të aktiviteteve si dhe ndërlidhjes së kësaj strategjie me strategjitë e tjera sektoriale të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Institucionet që kanë qenë pjesë e hartimit të kësaj strategjie janë:

1. Zyra për Planifikim Strategjik pranë Zyrës së Kryeministrit;
2. Ministria e Punëve të Brendshme;
3. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
4. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
5. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
6. Ministria e Ekonomisë;
7. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
8. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
9. Agjencia e Statistikave të Kosovës;
10. Ekspertë nga GIZ;
11. Ekspertë nga ICMPD/MIMAK.

1.4 Historiku (sfondi)

Migrimi është një fenomen kompleks me ndikim shumë-dimensional në sferat e ndryshme socio-ekonomike, demografike, politike dhe të sigurisë të vendeve të origjinës dhe atyre të destinimit. Lëvizjet migratore në nivel ndërkombëtar janë rritur për arsye të revolucionit digjital, reduktimit të kostos së udhëtimit, etj.³ Migrimi ndërkombëtar është në rritje e sipër dhe vlerësohet se në vitin 2019 ishin rreth 272 milion migrantë ndërkombëtar në nivel global (apo 3.5 % të popullsisë globale) krahasuar me 155 milion sa ishin në vitin 2000 (apo 2.8% të popullsisë globale).⁴ Kryesisht, migrimi ndërkombëtar ndodh në mënyra të rregullta si për çështje të punësimit, arsyeve familjare, arsimimit, dhe të ngjajshme. Poashtu, numri i refugjatëve të cilët kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare është në rritje e sipër. Në vitin 2020, vlerësohet se janë afër 26 milionë refugjatë në nivel global, të cilët gëzojnë të drejtat për mbrojtje specifike ligjore siç është mbrojtja nga dëbimi dhe nga penalizimi për kalimin e kufijve pa autorizim për të kërkuar siguri.

Përpyekjet ndërkombëtare për menaxhim të migrimit në forma të rregullta dhe ligjore dhe për të parandaluar format e parregullta të migrimit që shpesh rrezikojnë edhe jetën e njerëzve dhe motivon rritjen e grupeve kriminale që merren me trafikim me qenie njerëzore dhe kontrabandim me migrantë, kanë qenë të vazhdueshme. Në këtë kontekst, me 19 shtator 2016 kërret e shteteve dhe qeverive, u bashkuan që të diskutojnë në nivel global brenda Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara çështjet që ndërlidhen me migrimin. Kjo dërgoi një mesazh të rëndësishëm politik që migrimi është bërë çështje e rëndësishme në agjendën ndërkombëtare. Me miratimin e Deklaratës së Nju Jorkut⁵ për refugjatët dhe migrantët, 193 shtete anëtare të OKB-së e pranuan që ekziston nevoja për një qasje gjithëpërfshirëse për lëvizjen e njerëzve dhe forcim të bashkëpunimit në nivel global. Aneksi i II në Deklaratën e Nju Jorkut ka vënë në lëvizje procesin e konsultimeve ndërqeveritare dhe negociatat që kanë kulmuar në miratimin e Paktit Global për Migrim⁶ në konferencën për migrimin ndërkombëtarë në vitin 2018. Si i tillë, ky Pakt Global për Migrim, ka për synim, migrimin e sigurt, të organizuar dhe të rregullt.

Po ashtu, në vitin 2018 përpyekjet ndërkombëtare për të fuqizuar bashkëpunimin global në mbrojtjen ndërkombëtare të refugjatëve, u formalizuan me miratimin e Marrëveshjes Globale për Refugjatë në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Marrëveshje Globale për Refugjatët⁷ e cila u votua nga ana e 181 shteteve anëtare të OKB-së, ka 4 synime kryesore. 1) Ulja e presionit mbi vendet që strehojnë një numër të madh refugjatësh, 2) Sigurimi i kushteve që refugjatët të jenë të vetëmjaftueshëm në vendet ku jetojnë, 3) Zgjerimi i hyrjeve në

³Raporti i IOM-it 2020, faqe 19 https://publications.iom.int/system/files/pdf/wmr_2020.pdf

⁴Po aty/Ibid

⁵Deklarata e New York-ut: https://www.un.org/en/ga/search/vieë_doc.asp?symbol=A/RES/71/1

⁶Marrëveshja Globale për Migrim:

https://refugeemigrants.un.org/sites/default/files/180713_agreed_outcome_global_compact_for_migration.pdf

⁷https://ëëë.unhcr.org/gcr/GCR_English.pdf

vendet e treta dhe sistemimit në vendet e reja dhe 4) Mbështetja e kushteve të nevojshme për të siguruar rikthimin e refugjatëve në vendet e tyre.

Në bazë të një studimi të mbështetur nga GIZ-i përmes Programit Global për Migrimin dhe Disaporën, është konstatuar se korniza ligjore dhe strategjike në fushën e migrimit në Republikën e Kosovës, është në masë të konsiderueshme e harmonizuar me objektivat e Paktit Global për Migrim. Njëkohësisht, në këtë studim janë prezantuar edhe disa rekomandime që kanë për synim përfshirjen më të gjerë të të gjitha objektivave dhe indikatorëve të Paktit Global për Migrim në sistemin për menaxhimin e migrimit në Republikën e Kosovës. Në këtë kontekst, në kuadër të Strategjisë për Migrim 2021-2025 janë paraparë masa të cilat reflektojnë rekomandimet si në vijim: në krijimin e një platforme të përbashkët për shkëmbimin e të dhënave lidhur me flukset e përziera të migrimit; zhvillimit të kapitalit njerëzor duke përfshirë edhe krijimin e një sistemi për mbështetjen në procesin e riintegrit të tyre sipas parimeve të Paktit Global për Migrimin. Poashtu është rekomanduar të eksploroheh mundësitë dhe procedurat për kthimin në vendet e origjinës të migrantëve të parregullt sidomos me vendet të cilat ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës.

Në anën tjetër, përderisa objektivat e Paktit Global për Migrim janë të reflektuara në dokumente të ndryshme strategjike, implementimi i tyre në praktikë duhet të përmirësohet, sidomos kur kemi të bëjmë me masa komplekse siç është ekzaminimi dhe referimi i rasteve të grupeve të cënueshme të migrantëve, sidomos fëmijëve të pa shoqëruar dhe viktimave të trafikimit. Në këtë kontekst, Strategjia për Migrim 2021-2025 ka paraparë programe të specializuara të ngritjes së kapaciteteve për institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave të tilla.

Në anën tjetër, si pjesë e Paktit Global për Migrim janë edhe disa objektiva tjera të cilat pritet të adresohen në kuadër të strategjive sektoriale, sic është rasti me Objektivin 18 për zhvillimin e aftësive dhe njohjen reciproke të kualifikimeve e cila duhet të trajtohet në Strategjinë Sektoriale për Arsimin apo Objektivin 2 të Paktit Global përmes së cilit synohet të adresohen faktorët strukturor të cilët shtyjnë qytetarët të largohen nga vendi e cila duhet të adresohet përmes Strategjisë Kombëtare Zhvillimore 2021-2030. Rrjedhimisht, Strategjia e Migrimit 2021-2025 do të reflektoj parimet dhe objektivat e Paktit Global për Migrimin, në të gjitha çështjet të cilat ndërlidhen direkt apo indirekt me fushën e migrimit, duke krijuar sinergji me Strategjinë Zhvillimore 2021-2030 dhe Strategjitë tjera sektoriale. Poashtu si pjesë integrale e Strategjisë janë përfshirë edhe masa/aktivitete të cilat fokushen në çështjet gjinore, të cilat kanë dalur si rezultat i studimeve dhe trajnimeve të fundit në kuadër të dialogut me shumë palë të interesit i cili është zhvilluar nga AQM-ja me mbështetje të GIZ..

Ndërkohë, në Shtator të vitit 2020, Komisioni Evropian ka prezantuar Paktin e BE-së për Migrimin dhe Azilin⁸ i cili është i fokusuar në disa objektiva, një pjesë e të cilave janë reflektuar

⁸Pakti i BE-së për Migrimin dhe Azilin: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1601287338054&uri=COM%3A2020%3A609%3AFIN>

në Strategjinë e Migrimit 2021-2025. Këto objektiva përfshijnë: menaxhimin efikas të kufijve përfshirë kontrollin e sigurisë dhe ekzaminimin shëndetësor; procedurat efikase të azilit, zbatimin efikas të procedurave të kthimit të migrantëve në vendet e origjinës; qeverisjen e migrimit; konsolidimin e politikave për integrimin e të huajve, etj. Pakti i BE-së për Migrimin dhe Azilin parasheh legjislacionin ri në fushën e Migrimit dhe Azilit. Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Kosovës në kuadër të Programit Kombëtar për zbatimin e MSA-së do të reflektojë masat të cilat synojnë harmonizimin e legjislacionit aktual dhe atij në të ardhmën i cili do të zhvillohet nga BE-ja.

Situata e krijuar nga pandemia me Covid-19 ka pasur ndikim edhe në fushën e migrimit për shkak të masave të ndërmarra nga shtetet e ndryshme, përfshirë edhe mbylljen e kufijve. Që nga fillimi i pandemisë Republika e Kosovës është ballafaquar me një numër të konsiderueshëm të migrantëve të 'ngujuar' brenda territorit të Republikës së Kosovës. Masat parandaluese u prezantuan për të mbrojtur migrantët nga pandemia, duke përfshirë kufizimin e lëvizjes dhe karantinën për migrantët dhe aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare në ardhje.⁹Kjo ka ndikuar në stër-ngarkimin e sistemit vendor të pritjes dhe akomodimit të migrantëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, ku përveç shfrytëzimit të hapësirave në Qendrën e Azilit në Magure, është vënë në funksion edhe objekti i Qendrës së Pritjes në Vranidoll. Poashtu, me qëllim të menaxhimit të ndonjë fluksi të mundshëm, Ministria e Punëve të Brendshme, në kuadër të Planit të Reagimit për menaxhimin e fluksit të migrantëve, refugjatëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, ka planifikuar zgjerimin e hapsirave në kuadër të kampit 'Belvedere' duke rritur kështu kapacitetin e përgjithshëm akomodues nga 800 sa është aktualisht në 2,500. Trendi i ngjashëm i qëndrimit të migrantëve në territorin e Kosovës ka vazhduar edhe në muajt në vijim.

Poashtu, situata me pandeminë Covid-19 ka ndikuar edhe në kthimin e organizuar të shtetasve të Kosovës që kanë mbetur të bllokuar në shtetet e ndryshme për arsye të humbjes së vendit të punës, duke përfshirë këtu edhe kategorinë e studentëve dhe të tjerët që kanë udhëtuar për qëllime biznesore apo vizita familjare. Edhe pse nuk ka të dhëna të sakta zyrtare rreth numrit të kthyer gjatë kësaj kohe, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes ambasadave të Republikës së Kosovës ka asistuar këtë proces gjatë të gjithë fazave.

Procesi i ripranimit të shtetasve Kosovarë me qëndrim të paligjshëm në vendet e BE-së dhe zonës Shengen është suspenduar për disa muaj gjatë mbylljes së kufijve dhe kjo ka rezultuar me një numër dukshëm më të ulët të ripranuarëve në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019.

Autoriteti Qeveritar për Migrim, me përkrahjen e projektit MIMAK kanë organizuar një punëtori nga datat 3 deri 6 Nëntor 2020 që ka pas për qëllim hartimin e dokumenteve të Përmbledhjes Informative të Politikave me tematikë të ndikimit të pandemisë Covid-19 në migrim në Kosovë. Pjesëmarrët në këtë punëtori kanë identifikuar çështjet dhe sfidat që janë të ndërlidhur me ndikimin e pandemisë në fushën e migrimit në rastin e Kosovës. Çështjet si trajtimi i migrantëve

⁹Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2020, faqe 46

të ngujuar në vend si rezultat i mbylljes së kufijve shtetërorë si një ndër çështjet më sfiduese dhe prioritare që kërkon adresim nga institucionet shtetërore. Rekomandimet që janë dhënë në kuadër të këtyre përmbledhje informative të politikave do të jenë pjesë e masave që parasheh kjo strategji.

Në këtë drejtim, Strategjia për Migrim 2021-2025 ka reflektuar mbi ndikimin e pandemisë në fushat që ndërlidhen me migrimin dhe ka paraparë masa për tejkalimin e pasojave të shkaktuar nga kjo pandemi. Strategjia gjithashtu reflekton mbi ndikimin e pandemisë në mobilitet dhe efektet që mund të ketë në lëvizjet migratore si në aspektin e emigrimit të shtetasve Kosovare në veçanti për qëllime punësimi, ashtu edhe në aspektin e imigrimit dhe fuqizimin e kapaciteteve e pritjes dhe trajtimit të migrantëve dhe atyre në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Kosova, sikurse pjesa dërmuese e vendeve të rajonit ballafaqohet me sfida të natyrave të ndryshme sa i përket migrimit. Si emërues të përbashkët të këtyre sfidave mund të konsiderohen numri gjithnjë në rritje i aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, kontrabandimi me migrantë dhe trafikimi me qenie njerëzore, qeverisja e migrimit, sistemi dhe infrastruktura e pritjes së migrantëve, etj. Pra, Republika e Kosovës sikurse dhe vendet tjera të rajonit ndikohet nga migrimi qoftë si vend i origjinës, tranzitit dhe në raste të caktuara edhe destinimit. Në këtë drejtim, Strategjia për Migrim 2021-2025 ngërthen në vete masa konkrete për të adresuar problematikën, ndërsa është komplementare me dokumentet tjera strategjike siç është rasti me Planin për menaxhimin e një fluksi të mundshëm të migrantëve në Kosovë.

Kosova është prekur nga lëvizjet migratore nëpër disa etapa përgjatë historisë, në veçanti me emigrimin e Kosovareve në vendet Evropiane. Numri i popullsisë Kosovare të emigruar dhe asaj me prejardhje Kosovare (1969-2011) është vlerësuar të jetë rreth 703.978 banorë, përderisa në fund të vitit 2020 vlerësohet të jetë rreth 885,862 (net stoku i migrimit) banorë ¹⁰. Shumica prej tyre jetojnë në Gjermani (me një pjesëmarrje prej 39%), Zvicër (23%), Itali (7%), Austri (7%) dhe Suedi (7%) dhe 17% në shtetet tjera.

Reformat legjislative dhe institucionale në fushën e migrimit të filluara nga viti 2009, janë ndikuar dukshëm nga dy procese më vonë, ai i liberalizimit të vizave (që nga viti 2012) me Bashkimin Evropian dhe agjendën për integrim në Bashkimin Evropian me fillimin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit në vitin 2016, në veçanti me zbatimin e kritereve që kanë rrjedhur nga Udhërrëfyesi për liberalizim të vizave me Bashkimin Evropian dhe Kapitullin e 7 të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian, përkatësisht dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me migrim të parregullt, migrim të rregullt dhe ato të ripranimit dhe ri-integrimit të personave të riatdhesuar.

Si rezultat i reformave të ndërmarra në kuadër të këtyre dy proceseve, Kosova ka zhvilluar një kornizë të mirëfilltë ligjore dhe strategjike në menaxhimin e migrimit duke përfshirë edhe

¹⁰Vlerësim, Popullsia e Kosovës 2020, Prishtinë, Qershor 2021: <https://ask.rks-gov.net/media/6105/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2020.pdf>

mekanizmat institucional të mandatuar të koordinojnë dhe zbatojnë politikat e migrimit. Raporti i Vendit i Komisioni Evropian 2020 për Kosovën vlerëson se Kosova ka harmonizuar në masë të madhe kornizën ligjore në fushën e migrimit.¹¹ Për më tepër përafrimi i legjislacionit në fushën e migrimit me legjislacionin e BE-së vazhdon në përputhje me Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian. Përgjatë vitit 2020, Ministria e Punëve të Brendshme me mbështetjen e GIZ-it ka ndërmarrë një analizë gjithëpërfshirëse lidhur me nivelin e harmonizimit të legjislacionit vendor me Kapitullin 24 të EU *Acquis* përkatsisht në çështjet të cilat ndërlidhen me Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë. Ky vlerësim ka konstatuar shkallë të lartë të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me *Acquis* të BE-së në fushën e migrimit. Ky vlerësim nënvizon se pothuajse 100% e legjislacionit vendor për migrim të rregullt konsiderohet të jetë në harmonizim të plotë ose të avancuar me *Acquis* të BE-së për migrim të ligjshëm, përkatësisht rreth 33 % e legjislacionit kombëtar është harmonizuar plotësisht me *Acquis* të BE-së kurse 77% ka harmonizim të avancuar me *Acquis* të BE-së. Ndërsa sa i përket migrimit të parregullt, vlerësimi konstaton se Kosova ka arritur përparim të konsiderueshëm në harmonizimin e legjislacionit kombëtar me *Acquis* të BE-së. Vlerësimi nënvizon se pothuajse 80% e legjislacionit vendor për migrim të parregullt konsiderohet të jetë në harmonizim të plotë ose të avancuar me *Acquis* të BE-së, kurse 20% ka harmonizim të pjesshëm me *Acquis* të BE-së për migrim të parregullt.

Reformat e lartë-cekura kanë rezultuar edhe me vendosjen e mekanizmave institucional që kanë të bëjnë me parandalimin e migrimit të parregullt dhe menaxhimin e formave të rregullta për migrim. Në këtë drejtim, në vitin 2013 është themeluar Autoriteti Qeveritar për Migrim (AQM) si mekanizëm ndër-institucional për të koordinuar politikat që kanë të bëjnë me menaxhim të migrimit në Kosovë. Për më tepër janë krijuar mekanizmat për ripranim, ri-integrimin e personave të riadhtesuar, janë fuqizuar mekanizmat për kontroll të kufirit dhe parandalim të migrimit të parregullt dhe luftimin e kontrbandimit me migrantë. Poashtu është krijuar sistemi i mbrojtjes ndërkombëtare mbi azilin që vlerësohet të jetë në masë të madhe në përputhje me normat Evropiane dhe ndërkombëtare.

Këto reforma të ndërmarra ishin edhe pjesë e Strategjisë Kombëtare për Migrim 2013-2018 si dokumenti kyç strategjik në fushën e menaxhimit të migrimit në Kosovë. Bazuar në vlerësimin përfundimtar të zbatimit të Strategjisë së Migrimit 2013-2018, rezultatet e vlerësimit janë si në vijim:


- 40 aktivitete (60%) janë implementuar (shumica e tyre është përkufizuar si “në vazhdimësi” gjë që ka kuptimin se implementimi nënkupton vazhdimësinë e veprimeve të iniciuara që më parë)
- 14 aktivitete (21%) janë implementuar në mënyrë të pjesshme.
- 11 aktivitete (16%) nuk janë implementuar.

¹¹Raporti i BE-së 2020 për Kosovën, faqe 46

Në rastin e dy (2) aktiviteteve (3%) ka qenë e pamundur të vlerësohet niveli i implementimit për shkak të mungesës së të dhënave. Shumica e aktiviteteve të përfunduara ndërlidhen me objektivin strategjik që adreson parandalimin e migrimit të parregullt, dhe kjo si rezultat masave të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe autoritetet përkatëse për të adresuar fenomenin e emigrimit të parregullt (në veçanti në vitin 2014 dhe 2015) dhe në adresimin e faktorëve shtytës dhe nxitës të emigrimit të parregullt.

Edhe përkundër progresit të bërë në konsolidimin e sistemit për menaxhim të migrimit dhe atij për mbrojtje ndërkombëtare, Republika e Kosovës është përballur me fenomenin e emigrimit të parregullt të viteve 2014 dhe 2015 drejt vendeve të BE-së që konsiderohet të ishte shkaktuar për arsye ekonomike dhe sociale në vend, por edhe nga faktorët tjerë tërheqës siç mund të jenë ndryshimi i legjislacionit të azilit në Hungari gjatë vitit 2013, largimi i Kosovës nga lista e vendeve të sigurta nga ana e Francës, por edhe arsyet tjera që kanë të bëjnë me qarkullim relativisht të lehtë dhe më pak të kushtueshëm përgjatë territorit të Serbisë për në Hungari. Ky fluks i emigrimit filloi të shënojë rënie nga pjesa e dytë e vitit 2015, siç dëshmon edhe figura si në vijim, ku në vitin 2019 është shënuar rënie të dukshme të emigrimit të parregullt nëse i referohemi vetëm numrit të azil-kërkuesve në shtetet e BE-së.

Figura 1: Trendi i kërkesave për azil dhe i kërkesave për mbrojtjen ndërkombëtare për herë të parë të shtetasve Kosovarë drejt shteteve anëtare të BE-së dhe Zonës Schengen, 2016 – 2020



Burimi: EUROSTAT¹²


Trendet rreth emigrimit të parregullt dhe numrit të aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare me origjinë nga Republika e Kosovës tregojnë rënie të konsiderueshme në vazhdimësi (2015-2020), megjithatë garantimi i migrimit të sigurtë dhe të rregullt duhet të mbetet ndër prioritet e kësaj strategjie, si nga aspekti i kontrollit të kufirit, zbatimit të politikave të ripranimit dhe ri-integrimit dhe marrjen e masave për informimin e qytetarëve për pasojat e migrimit të parregullt dhe për të

¹²<https://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-migration/data/database>, e përditësuar me 13.04.2021, (6:50:38 AM), Extracted on 5/17/2021 (10:14:28 AM) –

drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga lëvizja e lirë pa viza në zonën Schengen pas liberalizimit të vizave.

Në anën tjetër, edhe përkundër faktit se mungojnë të dhënat zyrtare, shteti ynë përballet me largimin e kuadrove apo “humbjes së trurit”. Kjo dukuri është ngritur si shqetësim në nivel të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pasi që personeli mjekësor po largohet nga vendi për qëllime punësimi, veçanërisht në Gjermani. Të dhënat për emigrim të rregullt që nga viti 2015 kanë filluar të kenë një ngritje në veçanti për qëllime të punësimit.

Figura 2: Shtetasit Kosovarë me leje qëndrimi të vlefshme në shtetet anëtare të BE-së dhe Zonës Schengen sipas arsyes së qëndrimit, 2015-2019¹³




Burimi Eurostat

Ndërsa, duke pasur parasysh se migrimi i rregullt i të huajve në Republikën e Kosovës shënon një trend në rritje, (siç tregon Figura e mëposhtme) në veçanti për qëllime të punësimit, nënvizon nevojën e konsolidimit të mekanizmave për integrimin e të huajve me qëndrim të ligjshëm në shoqërinë Kosovare si dhe krijimin e politikave që kanë për qëllim punësimin e të huajve në përputhje me nevojat e tregut të punës.


¹³Burimi: Eurostat, <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

Figura 3: Trendi i leje-qëndrimeve të përkohshme, krahasim i kategorive “Bashkimi Familjar”/“Punësim” (2015-2019)



Politikat që kanë ndikuar në zvogëlimin e migrimit të parregullt mund t’i atribuohen edhe zbatimit të politikave të ripranimit dhe ri-integrimit të personave të riatdhesuar. Duhet theksuar se këto dy politika janë konstatuar të kënaqshme në praktikë, siç dëshmojnë edhe statistikat e paraqitura në figurat si më poshtë:

Figura 4: Ripranimi vullnetar dhe me forcë sipas viteve, 2015–2020




Burimi: MPB, IOM

Rritja e numrit të të ripranuarve në vitin 2015 dhe 2016 ka rezultuar edhe me rritjen e numrit të përfituesve nga skemat e ndryshme për ri-integrim përgjatë këtyre viteve. Ri-integrimi i personave të riatdhesuar tani e tutje do të adresohet në kuadër të Strategjisë për Migrim 2021-

2025 në përputhje edhe me Rregulloren Nr.22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.¹⁴

Figura 5: Numri i përfituesve nga skemat e riintegrimin, 2015-2020



Burimi: DRPR, MPB

Ndërkohë, si rezultat i vendosjes së masave kufizuese me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë Covid-19, përgjatë vitit 2020 kemi pasur një rënie të numrit të personave të ripranuar, përkatësisht 582 persona, prej tyre 478 me forcë dhe 104 persona të kthyer përmes Programit për Kthim dhe Riintegrim të Asistuar Vullnetar.


Republika e Kosovës ka nënshkruar 22 marrëveshje me 24 shtete në fushën e ripranimit¹⁵. Ripranimi si politikë shtetërore do të vazhdojë të zbatohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës në vitet e ardhshme si masë e rëndësishme që kontribuon në parandalimin e migrimit të parregullt. Në këtë drejtim, rekomandohet të vazhdojë me negociimin e marrëveshjeve për ripranim. Gjatë vitit 2021 janë inicuar nismat për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me këto shtete: Letoninë (marrëveshja është finalizuar dhe pritet nënshkrimi); Mbretërinë e Bashkuar, Portugalinë, Lituaninë, Poloninë, Irlandë, Pakistanin, Afganistanin, Bregun e Fildishtë, SHBA-të, Egjiptin, Jordaninë, Libinë dhe Qadin.Poashtu, Republika e Kosovës duhet të vazhdojë me fuqizimin (apo krijimin) e mekanizmave për kthimin e migrantëve të parregullt në përputhje me standardet dhe praktikatat e BE-së si dhe ato ndërkombëtare.

¹⁴<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31862>

¹⁵Republika e Kosovës ka nënshkruar Marrëveshjet Dypalëshe për Ripranim me këto vende: Shqipëria, Franca, Zvicra, Gjermania, Danimarka, Austria, Norvegjia, Sllovenia, Beneluksi (Belgjika, Holanda, Luksemburgu), Çekia, Mali i Zi, Suedia, Finlanda, Hungaria, Bullgaria, Malta, Estonia, Lihtenshtajni, Kroacia, Italia, Turqia dhe Maqedonia e Veriut.

Në anën tjetër, kriza me migrantë që ka prekur shtetet Evropiane duke shfrytëzuar ‘Rrugën Ballkanike’, përkatësisht vendet e rajonit ishte një tregues që Kosova mund të përdoret si vend tranzit për migrantët dhe refugjatët edhe pse Kosova nuk është prekur në atë masë sa vendet tjera të rajonit.

Figura 6: Azil-kërkuesit në Kosovë, 2016-2020



Burimi: DSHAM/MPB

Numri i azil-kërkuesve në Kosovë gjatë vitit 2020 ka qenë 1,409, duke shënuar rënie nga viti paraprak, mbase për shkak të situatës me pandeminë Covid-19 e cila ka ndikuar edhe në lëvizjet migratore. Vendet kryesore të origjinës së aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare në Kosovë janë: Siria 649 (46,1%), Maroku 183 (13%), Palestina 121 (8,6%), Irak 119 (8,4%), Libi 89 (6,3%) kurse shtetet e tjera 248 (17,6%). Grupmosha më e përfaqësuar është 18-34 vjeç (1,007 aplikues), 35-64 vjeç (204 aplikues), 0-13 vjeç (119 aplikues) grupmosha 14-17 vjeç (78 aplikues), dhe grupmosha 65+ (1 aplikues).

Ndërkohë, nga Janari 2020 kur është aktivizuar Neni 52 i Ligjit për Azil, që ju ofron mundësinë migrantëve dhe refugjatëve të aplikojnë “Për shprehjen dhe qëllimin për të kërkuar mbrojtjen ndërkombëtare” dhe të kenë mundësinë që brenda 72 orëve të vendosin për aplikim për mbrojtje ndërkombëtare, është krijuar një situatë të re sa i përket numrit të përgjithshëm të migrantëve dhe atyre të cilët aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare. Nga data 31 Janar 2020, kur ka hyrë në fuqi 72 orësh-i “Shprehja e qëllimit për të kërkuar azil”, deri më 31 Dhjetor 2020, 1,532 migrantë kanë shprehur qëllimin për të kërkuar azil, ndërsa 1,365 persona kanë aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare¹⁶.

Duke pas parasysh se trendet e lëvizjeve migratore në rajon vazhdojnë duke ndryshuar rrugët, dhe në këtë drejtim Republika e Kosovës duhet të ndërmerr masa për tu ballafaquar me ndonjë

¹⁶Personat të cilët kanë shprehur qëllimin për të kërkuar azil, mund të kenë aplikuar dhe hyr në procedurat për mbrojtje ndërkombëtare

fluks të mundshëm të migrantëve dhe refugjatëve, si dhe të vazhdoj me konsolidimin e sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare dhe standardet e mbrojtjes për migrantë dhe refugjatëpërgjatë gjithë fazave të paraparë me legjislacion dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si dhe në përputhje me konceptet e menaxhimit humanitar të kufirit.¹⁷ Po ashtu, Republika e Kosovës ka hartuar legjislacionin përkatës me qëllim të integritit të të huajve duke mandatuar institucionet dhe mekanizmat për mbështetjen dhe koordinimin e integritit të të huajve me fokus tek personat me mbrojtje ndërkombëtare.

Republika e Kosovës ka filluar me dialogun për liberalizim të vizave në vitin 2012 dhe ky proces tani ka arritur në fazën e fundit të vendim-marrjes në kuadër të Këshillit të Bashkimit Evropian. Ky proces i vendim-marrjes është dëshmuar të jetë politik dhe aktualisht nuk ka indikacione për afate kohore se kur do të mund të filloj lëvizja pa viza në Zonën Schengen, megjithatë Republika e Kosovës duhet të filloj përgaditjet për menaxhimin e procesit pas-liberalizimit të vizave në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian për vendet e rajonit të cilat tanimë janë pjesë e Listës së Bardhë të Schengenit duke përfshirë këtu edhe indikatorët dhe masat në kuadër të 'mekanizmit të suspendimit'. Kjo nënkupton krijimin e mekanizmave koordinues institucional si dhe masat që kanë të bëjnë informimin e qytetarëve Kosovarë për të drejtat dhe obligimet që dalin nga lëvizja e lirë pa viza, edhe pse një numër i aktiviteteve informuese rreth temave të migrimit, përfshirë informimin e shtetasve të Kosovës për rregullat e lëvizjes së lirë pa viza janë ndërmarr në vitet e fundit.

Menaxhimi i migrimit nga aspekti institucional përfshin një numër të institucioneve që kanë përgjegjësi direkte dhe indirekte në zbatimin e legjislacionit dhe politikave që ndërlidhen me fushën e migrimit, ndërsa me qëllim të koordinimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve në këtë fushë, ashtu siç edhe është cekur më lartë në vitin 2013, me vendim të Qeverisë është themeluar Autoriteti Qeveritar për Migrim si mekanizmi koordinues ndër-institucional për menaxhimin e migrimit. Edhe pse ky mekanizëm ka kontribuar në fuqizimin e qasjes ndër-sektoriale në fushën e migrimit, sidomos përmes hartimit të profileve të migrimit, Raporti i Komisionit Evropian 2020 për Kosovën rekomandon fuqizimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional në fushën e migrimit. Andaj, kjo Strategji parasheh masat që kanë të bëjnë me fuqizimin e mekanizmave për qeverisjen e migrimit në Republikën e Kosovës, në veçanti përmes fuqizimit të Autoritetit Qeveritar për Migrim dhe institucioneve tjera të përfshira në menaxhimin e migrimit si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë të kapaciteteve.

Përmbledhja e aktiviteteve kryesore

¹⁷ Plani për Menaxhimin e Fluksit të mundshëm me Migrantë, Refugjatë dhe Aplikues për Mbrojtje Ndërkombëtare

Të gjitha aktivitetet e parapara në këtë Strategji, janë kostuar dhe është përcaktuar linja buxhetore përmes së cilës do të mbulohen financiarisht. Disa nga aktivitetet nuk do të mund të mbulohen nga Buxheti i Kosovës dhe si të tilla do të mbështeten nga donatorët përkatësisht organizatat ndërkombëtare të cilat mbështesin institucionet e Kosovës në fushën e migrimit dhe azilit në rradhë të parë GIZ, SDC, UNHCR, IOM, etj.

Për më tepër, Ministria e Punëve të Brendshme do të përfitoj asistencë nga projekti 'EU4 Justice and Home Affairs', si pjesë e Instrumentit të Para-antarësimit IPA II. Në kuadër të komponentit të tretë të këtij projekti, MPB-ja do të përfitoj një grant në vlerë prej 6.5 milion Euro të cilat do të mbështesin mes tjerash edhe menaxhimin e migrimit. Poashtu, në kuadër të programimit për IPA III, janë përfshirë projekte në fushën e menaxhimit të migrimit.

Aktivitetet kryesore të Strategjisë për Migrim 2021-2025 do të fokusohen në menaxhimin e lëvizjeve të migrimit të rregullt dhe qarkor, përmes masave adekuate siç janë marrëveshjet bilaterale, ofrimin e shërbimeve informuese dhe këshillëdhënëse për migrantë, avancimin e politikave dhe sistemit për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, avancimin e sistemit për integrimin e të huajve. Për më tepër në fokus të Strategjisë do të jetë garantimi i migrimit të rregullt dhe të sigurt duke ndërmarrë masa në funksion të parandalimit të migrimit të parregullt qoftë përmes rritjes së mbikqyrjes dhe kontrollit kufitar, forcimit të bashkëpunimit rajonal, fushatave informuese dhe masa tjera me qëllim të mbrojtjes së migrantëve nga trafikimi.

Për dallim nga dokumentet e kaluara strategjike, Strategjia për Migrim 2021-2025 është orientuar në drejtim të bërjes së migrimit të rregullt dhe të sigurtë dhe si e tillë ka një qasje zhvillimore. Poashtu, janë paraparë masa të cilat konsistojnë në zhvillimin e politikave dhe skemave që synojnë menaxhimin e migrimit për qëllime të punësimit dhe konsolidimin e sistemit të mobilitetit të migrantëve.

Poashtu, Strategjia për Migrim 2021-2025 është dokumenti i parë strategjik në nivel vendi e cila adreson problematikën e migrimit të brendshëm. Aktivitetet e parapara synojnë identifikimin e zbrazëtirave ligjore, institucionale dhe kapaciteve në menaxhimin e lëvizjeve të brendshme duke paraparë masa konkrete të cilat fokusohen në plotësim ndryshimin e kornizës ligjore (Ligji për Vendbanim dhe Vendqendrim 02/L-121), avancimin e bazës së të dhënave për migrimin e brendshëm si dhe aktivitete konkrete në drejtim të informimit të qytetarëve mbi domosdoshmërinë e regjistrimit të ndryshimit të vendbanimit dhe vendqëndrimit.

Strategjia për Migrim 2021-2025 reflekton të arriturat në fushën e menaxhimit të migrimit respektivisht në koordinimin ndër-institucional nën mandatin e Autoritetit Qeveritar për Migrim, përmes hartimit të dokumenteve analitike në fushën e migrimit (si profilet e migrimit), avancimin e kapaciteteve përmes trajnimeve tematike në fushën e migrimit dhe avancimin e sistemeve për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave në fushën e migrimit. Në këtë drejtim janë paraparë aktivitete të cilat synojnë fuqizimin e rolit dhe mandatit ligjor të Autoritetit Qeveritar për Migrim si dhe menaxhimin e migrimit bazuar në të dhëna përmes platformës së zhvilluar për

menaxhimin e të dhënave. Poashtu, Strategjia reflekton progresin e arritur në fushën e mbrojtjes ndërkombëtare duke paraparë njëkohësisht aktivitete shtesë për fuqizimin e sistemit në rradhë të parë duke planifikuar masa me qëllim të ngritjes së standardit të intervistimit e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare rrjedhimisht përmirësimit të kualitetit të vendimmarrjes.

1.5 Objektivat:

Në bazë të analizave të bëra në Profilin e Zgjeruar të Migrimit 2013-2017, si dhe bazuar në të dhënat fillestare nga hulumtimi i migrimit, grupi punues për hartimin e Strategjisë, ka vendosur objektivat e mëposhtme strategjike:

- Objektivi strategjik 1: Menaxhimi i migrimit të rregullt;
- Objektivi strategjik 2: Garantimi i migrimit të sigurt, të organizuar dhe të
- Objektivi strategjik 3: Menaxhimi i Migrimit të Brendshëm;
- Objektivi strategjik 4: Avancimi në fushën e menaxhimit të migrimit dhe fuqizimi i sistemit për mbrojtje ndërkombëtare.

Objektivi strategjik 1: Menaxhimi i migrimit të rregullt

Menaxhimi i migrimit të sigurt, të organizuar dhe të rregullt është synim i politikës shtetërore të Republikës së Kosovës dhe që ndërlidhet me parimet e Paktit Global për Migrim. Në këtë drejtim, Strategjia për Migrim synon të avancojë sistemin për menaxhimin e migrimit, duke paraparë masa për krijimin e kushteve për migrim të rregullt dhe qarkor, rrjedhimisht duke ndikuar në parandalimin e migrimit të parregullt.

Menaxhimi i migrimit të rregullt ka implikime pozitive në zhvillimin e qëndrueshëm qoftë të vendeve të originës po ashtu edhe të atyre të destinimit, si në aspektin e zhvillimit ekonomik poashtu në zhvillimin e kapitalit njerëzor. Në këtë frymë, ky objektivi strategjik refleton synimet e institucioneve të Republikës së Kosovës për të krijuar një ambient të përshtatshëm për mobilitetin dhe lëvizjen e migrantëve në forma të rregullta dhe të sigurta, duke përfshirë edhe promovimin e mbrojtjes së të drejtave të migrantëve.

Treguesi: Shkalla e menaxhimit të lëvizjeve të rregullta migratore

Nën këtë objektivi strategjik, janë paraparë objektivat specifike që do të ndihmojnë në realizimin e këtij objektivi:

Nr.	Objektivi specifik	Treguesit e rezultatit
1.1	Menaxhimi i procesit të migrimit të rregullt	Përpjesëtimi i rrjedhës neto të migrimit të parregullt
1.2	Avancimi i politikave dhe sistemit për riintegrimin e qëndrueshëm të migrantëve të kthyer	Profili i migrantëve të kthyer të mbështetur me skema të riintegrimin i zgjeruar
1.3	Zhvillimi i politikave dhe skemave që synojnë menaxhimin e migrimit për qëllime të punësimit	Konsolidimi i Sistemit të mobilitetit të migrantëve bazuar në evidencë (të dhëna)
1.4	Fuqizimi i sistemit për integrimin e të huajve	Sistemi i integrimin funksional dhe me kapacitete adekuate për zbatim të politikave të integrimin

Objektivi strategjik 2: Garantimi i migrimit të sigurt dhe të rregullt

Parandalimi i migrimit të parregullt është sfidë për çdo shtet, duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës. Kosova ka arritur të konsolidoj kornizën ligjore dhe institucionale për parandalimin dhe luftimin e migrimit të parregullt. Sidoqoftë, duke qenë se lëvizjet migratore të parregullta mund të ndikohen nga zhvillime të pa parashikueshme në kontekst vendor, rajonal dhe ndërkombëtar, atëherë kjo mbetet një sfidë e vazhdueshme e cila kërkon vëmendje edhe në kuadër të kësaj Strategjie.

Në kuadër të këtij objektivi strategjik janë paraparë masa të cilat synojnë funksionalizimin e plotë të sistemit për menaxhimin e migrimit të ndjeshëm ndaj mbrojtjes. Në këtë drejtim është paraparë ngritja e kapaciteteve për Policinë Kufitare duke përfshirë edhe pajisjet e sofistikuar për marrjen e shenjave biometrike me qëllim të identifikimit, regjistrimit dhe referimit të rasteve nga flukset e përziera të migrantëve. Poashtu parashihet avancimi i infrastrukturës fizike për menaxhimin e fluksit të përzier të migrantëve përmes funksionalizimit të Qendrës së Pritjes.

Për më tepër, në kuadër të këtij objektivi strategjik është paraparë hartimi i Manualit për identifikimin, profilizimin dhe referimin e rasteve të migrantëve të parregullt dhe refugjatëve, me fokus në grupet e cenueshme, duke ju ofruar kujdesin e duhur dhe sigurinë adekuate.

Poashtu, në kuadër të këtij objektivi strategjik do të reflektohen edhe masa të cilat ndërlidhen me situatën e krijuar pandemike me Covid-19, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në nevojën për të pasur ekzaminime mjekësore, verifikim të sigurisë, si dhe mundësinë për të pasur informata sa më të kompletuara për flukset e përziera të migrantëve në vendin tonë.

Treguesit e rezultatit: Zvogëlimi i rasteve të migrimit të parregullt

Nën këtë objektivi strategjik, janë paraparë objektivat specifike që do të ndihmojnë në realizimin e këtij objektivi:

Nr.	Objektivi specifik	Treguesit e rezultatit
2.1	Informimi i qytetarëve të Kosovës për rregullat e hyrjes dhe qëndrimit në zonën Schengen;	Hulumtimi lidhur me shkallën e informimit të qytetarëve për rregullat e lëvizjes në zonën Schengen
2.2	Avancimi i bashkëpunimit të institucioneve të Kosovës me shtetet tjera në garantimin e migrimit të rregullt dhe të sigurt	Numri i migrantëve të parregullt të kthyer vendet e origjinës dhe prejardhjes përmes mekanizmave të kthimit
2.3	Avancimi i sistemit të kontrollit të hyrjes dhe qëndrimit të huajve në Republikën e Kosovës	Sistemi i kontrollit të hyrjes dhe qëndrimit i avancuar
2.4	Mbrojtja e migrantëve nga trafikimi	Numri i viktimave të migrantëve të trafikuar, të mbrojtur

Objektivi strategjik 3: Menaxhimi i migrimit të brendshëm

Strategjia për Migrim 2021-2025 është dokumenti i parë strategjik i cili synon të adresoj mangësitë të cilat ndërlidhen me lëvizjet e brendshme migratore (regjistrimi i lëvizjeve fshat-qtet dhe anasjelltas apo komunë-komunë) të cilat do të ndihmojnë në orientimin e politikave publike në fushën e edukimit, punësimit, çështjeve sociale, planifikimit të buxhetit, investimeve nga jashtë, etj, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik në vend. Në këtë drejtim janë identifikuar objektiva specifike dhe aktivitete të cilat synojnë strukturimin dhe zhvillimin e sistemit të lëvizjeve të brendshme të migrimit.

Treguesit e rezultatit: Shkalla e regjistrimit të migrimit të brendshëm

Nën këtë objektiv strategjik, janë paraparë objektivat specifike që do të ndihmojnë në realizimin e këtij objekti:

Nr.	Objektivi specifik	Treguesit e rezultatit
3.1	Rishikimi i sistemit aktual të migrimit të brendshëm	Identifikimi i zbrazëtirave ligjore, procedurale, insitucionale dhe kapaciteteve lidhur me lëvizjet e brendshme migratore
3.2	Avancimi i sistemit për menaxhimin e migrimit të brendshëm	Disponueshmëria e të dhënave lidhur me migrimin e brendshëm për hartimin e politikave bazuar në të dhëna

Objektivi strategjik 4: Avancimi në fushën e menaxhimit të migrimit dhe fuqizimi i sistemit për mbrojtje ndërkombëtare

Qeverisja e migrimit i referohet sistemit dhe mekanizmave institucional të përfshirë në menaxhimin e migrimit. Autoriteti Qeveritar për Migrim¹⁸, i themeluar në vitin 2013, ka ofruar brenda një mekanizmi, institucionet relevante qeveritare dhe agjencitë ekzekutive të cilat brenda kornizës së mandatit të tyre ushtrojnë funksione që ndërlidhen me fushën e migrimit. Në kuadër të Autoritetit Qeveritar të Migrimit janë të përfshira të gjitha institucionet relevante të cilat janë të përfaqësuara nga zyrtarët përgjegjës të nominuar për të qenë pjesë e këtij mekanizmi. Megjithatë puna e anëtarëve të këtij autoriteti është jashtë përgjegjësive të tyre të përditshme, AQM ka finalizuar Rregulloren e cila përcakton detyrat, rolin dhe përgjegjësinë e këtij autoriteti. Gjithashtu, me qëllim të funksionimit sa më efikas në drejtim të arritjes së objektivave strategjike dhe specifike, është nënvizuar nevoja për zhvillimin e procedurave të qarta të punës së AQM-së për secilën fushë që ka përgjegjësi ky autoritet.

Një tjetër sfidë që e ka përcjell punën e Autoritetit përgjatë këtij pesë-vjeçari ka qenë mungesa e të dhënave të ndryshme në formë të strukturuar të cilat janë të domosdoshme për hartimin e Profileve të lehta dhe të zgjeruara të Migrimit si dhe për zhvillimin e hulumtimeve dhe analizave të ndryshme, dhe pregaditjen e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes dhe zhvillimin e politikave publike duke shfrytëzuar migrimin si shtyllë të zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik. Gjithashtu, pas hulumtimit të parë të realizuar në Kosovë që i është dedikuar fushave të ndryshme të migrimit, AQM planifikon të përcjell nga afër gjendjen lidhur me të dhënat e grumbulluar, e cila do të pasohet me një hulumtim të radhës i

¹⁸Vendimi 08/158 për themelimin e Autoritetit Qeveritar për Migrim http://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_158-te_te_Qeverise_2013_.pdf

planifikuar të zhvillohet brenda një periudhe prej 5 viteve. Avancimi i bashkëpunimit dhe partneritetit shumëpalësh në nivelet rajonale dhe ndërkombëtare është një tjetër sfidë dhe synim për AQM-në në 5 vjeçarim e ardhshëm.

Përgjatë këtyre 5 viteve të funksionimit, AQM me mbështetjen të partnerëve ndërkombëtar ka arritur të konsolidohet si mekanizëm përgjegjës në fushën e migrimit duke arritur të prodhojë në baza vjetore dokumente strategjike, hulumtime dhe analiza të cilat shërbëjnë për të kuptuar lëvizjet migratore dhe zhvillim të politikave publike me fokus zhvillimin. Përkundër progresit të arritur, AQM vazhdon të përballet me sfida të brendshme të funksionimit të cilat ndërlidhen me mos-definimin e tërësishëm të rolit të saj, përfshirë përgjegjësitë e antarëve të cilët janë të deleguar dhe nuk e kanë angazhimin në AQM si pjesë primare e punës së tyre të përditshme. Për të adresuar të gjitha këto sfida dhe me qëllim të forcimit të rolit të AQM-së si mekanizëm primar ndër-institucional dhe pikë referencë në fushën e migrimit, janë paraparë objektivat specifike dhe aktivitete konkrete të cilat janë të reflektuara si në vijim.

Poashtu në kuadër të këtij objektiivi janë paraparë masa të cilat synojnë fuqizimin e sistemit për mbrojtje ndërkombëtare duke qenë se të dhënat zyrtare flasin për një rritje të konsiderueshme të numrit të aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare në Kosovë. Masat e parapara fokusohen kryesisht në ngritjen e kapaciteteve për intervistim, vendim-marrje, referim dhe trajtim të rasteve të cilat janë pjesë e grupeve të cenueshme. Në këtë drejtim synohet avancimi i mëtutjeshëm i sistemit për mbrojtje ndërkombëtare në përputhje edhe me parimet e Paktit Global për Refugjatë, Paktit Global për Migrim dhe Paktit të BE-së për Migrim dhe Azil.

Treguesi i rezultatit: Zhvillimi i Politikave publike në fushën e migrimit të bazuar në të dhëna

Nën këtë objektiv strategjik, janë paraparë objektivat specifike që do të ndihmojnë në realizimin e këtij objektiivi:

Nr.	Objektiivi specifik	Treguesit e rezultatit
4.1	Fuqizimi i rolit të Autoritetit Qeveritar për Migrim (AQM)	Avancimi i AQM-së në nivel strategjik dhe teknik dhe me përbërje të plotë ndër-institucionale
4.2	Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ për menaxhimin e migrimit (SIMM)	Sistemi informativ për menaxhimin e migrimit (SIMM) plotësisht operacional
4.3	Avancimi i bashkëpunimit dhe partneritet shumë-palësh në nivel rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e migrimit	Anëtarësimi në organizatat dhe forumet ndërkombëtare në fushën e migrimit
4.4	Menaxhimi efikas i të dhënave në fushën e migrimit	Politik-bërja dhe vendimarrja në menaxhimin e migrimit e bazuar në të dhëna
4.5.	Fuqizimi i sistemit për mbrojtje ndërkombëtare	Ngritja e kapaciteteve lidhur me cilësinë dhe kohëzgjatjen e vendimarrjes

1.6. Shtojcat

- I. Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit;
- II. Vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm për themelimin e Grupit Punues për hartimin e Strategjisë së Migrimit 2021-2025;
- III. Vlerësimi i Projektit të Binjakëzimit për Strategjinë për Migrim 2013-2018;
- IV. Korniza ligjore në fushën e migrimit;
- V. Korniza e politikave;
- VI. Mekanizmat institucional të përfshirë në fushën e migrimit;
- VII. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e migrimit.

I. Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit

Ministria e Punëve të Brendshme do të jetë bartësi kryesor i zbatimit të Strategjisë për Migrim 2021-2025, duke u ndihmuar nga insitucionet përkrahëse. Për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit të Strategjisë së Migrimit 2021-2025, do të angazhohet Sekretariati i AQM-së në koordinim me Sekretariatit për Strategji në kuadër të MPB-së, i cili do të përgatis:

- Raporte 6 mujore për arritjen e objektivave strategjike dhe për zbatimin e planit të veprimit. Raporti 6 mujor do të përmbajë informata për arritjen e objektivave dhe zbatimit të aktiviteteve. Në kuadër të raportit 6 mujor, në veçanti do të nënvizohen vështirësitë e hasura, sfidat, rreziqet e identifikuar dhe adresimin e tyre për zbatimin e strategjisë.
- Raporte vjetore për arritjen e objektivave strategjike dhe për zbatimin e planit të veprimit. Raporti vjetor i progresit do të përmbajë informata për arritjen e objektivave dhe zbatimit të aktiviteteve. Në kuadër të raportit vjetor, nëveçanti do të nënvizohen vështirësitë e hasura, sfidat, rreziqet e identifikuar dhe adresimin e tyre për zbatimin e strategjisë. Të gjeturat dhe rekomandimet nga raportet vjetore të monitorimit të mbi zbatimit të Strategjisë do të shërbëjnë si bazë përgjatë rishikimit afat-mesëm të Planit të Veprimit si dhe hartimit të Strategjisë së ardhshme të Migrimit 2026-2030.

- raporti 6 mujor i zbatimit;
- raporti vjetor i zbatimit;
- raporti përfundimtar i zbatimit.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë për Migrim 2021-2025 janë:

1. Ministria e Punëve të Brendshme;
2. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
3. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
4. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
5. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
6. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
7. Agjencia e Statistikave;
8. Policia e Kosovës;
9. Autoriteti Qeveritar për Migrim.

Mekanizmi i Monitorimit dhe Raportimit të Strategjisë për Migrim 2021-2025 dhe Planit të Veprimit

Mekanizmi i monitorimit do të korrespondojë me parimet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për: Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit, në Doracakun për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit.

Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Migrim 2021-2025 dhe për ndërmarrjen e veprimeve, nëse është e nevojshme, për të siguruar zbatimin në kohë dhe në mënyrë efektive të aktiviteteve të

përcaktuara në Planin e Veprimit. Autoriteti përgjegjës për përgatitjen e raporteve sipas mandatit është Sekretariati i AQM-së në koordinim me Sekretariatit për Strategjitë i cili funksionon në kuadër të MPB-së.


Raportet e progresit që do të përgatiten:

	Autoriteti Përgjegjës për hartimin e raportit	Afati i fundit	Finalizimi i Raportit
Raporti 6 mujor	Sekretariati AQM/Sekretariati për Strategjitë (MPB)		AQM/SS
Raporti vjetor i implementimit	Sekretariati AQM/Sekretariati për Strategjitë (MPB)		Nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm (MPB)
Raporti Përfundimtar	Sekretariati AQM/Sekretariati për Strategjitë (MPB)		Nënshkruar nga Ministri i Punëve të Brendshme

Në rast të ndonjë problemi të theksuar gjatë implementimit ose në rast të rrethanave të ndryshuara, ministria përgjegjëse e informon Zyrën për Planifikim Strategjik (ZPS) në kohën e duhur. Ministria përgjegjëse dhe ZPS, pas vlerësimit të situatës së përbashkët, do të propozojnë veprimin e nevojshëm për Komisionin e Planifikimit Strategjik.

Hapat për pregaditjen e raportit 6 mujor

Mekanizmi për hartimin e raportit 6 mujor



Shkurtesat:

SiS- Sekretariati i Strategjive (MPB);

AQM- Autoriteti Qeveritar për Migrim;

KNM - Koordinatorin Nacional për Migrim

Sipas skemës nr. 1, AQM dhe SiS do të dërgojn kërkesën në ministritë e linjës dhe tek institucionet tjera, e cila përfshin listën e aktiviteteve, për të cilat është përgjegjës çdo institucion. Institucionet përgjegjëse, gjithashtu, duhet të ofrojnë informacion mbi problemet dhe rreziqet dhe mbi hapat e mundshëm të mëtejshëm për zgjidhjen e problemeve. Informacioni i përfshirë në draft raport do të diskutohet dhe analizohet nga AQM dhe SiS dhe pas finalizimit, i raportohet Koordinatorit Kombëtar për Migrim.

Raporti 6 mujor do të përmbajë¹⁹:

Informata përmbledhëse: *(më së shumti 1 faqe)*

Progresi i përgjithshëm

Në këtë seksion, jepen informatat në vijim:

- a) numri i përgjithshëm i veprimeve të vlefshme për gjashtë muajt e mbuluar;
- b) informacion mbi normën e përgjithshme të implementimit, p.sh. përqindjen dhe numrin e veprimeve të implementuara plotësisht, pjesërisht dhe fare (të implementuara);
- c) fushat që tregojnë performancën më të mirë dhe më të dobët (në bazë të objektivave).

Problemet dhe rreziqet

Në këtë seksion paraqitet një përmbledhje e shkaqeve kryesore për vonesat në veprimet implementuese. Theksohet çdo rrezik për implementimin e mëtejshëm të veprimeve dhe për arritjen e objektivave.

Hapat e ardhshëm

Sugjerohen zgjidhje të mundshme për problemet e identifikuar dhe hapat e ardhshëm drejt implementimit të dokumentit strategjik.


Informata të detajuara për implementimin e aktiviteteve

Në këtë seksion jepen informata mbi statusin e implementimit të veprimeve, së bashku me një përshkrim të shkurtër të progresit kundrejt çdo veprimi, treguesit (e rezultateve), ndonjë problem i identifikuar dhe hapat e tjerë të propozuar.

¹⁹Doracak për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit. <http://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2019/02/MANUAL-P%C3%8BR-PLANIFIKIMIN-HARTIMIN-DHE-MONITORIMIN-E-DOKUMENTEVE-STRATEGJIKE-DHE-PLANEVE-T%C3%8B-TYRE-T%C3%8B-VEPRIMIT.pdf>

Hapat për përgaditjen e raportit vjetor

Mekanizmi për hartimin e raportit vjetor (të progresit)



Sipas skemës nr. 2, AQM dhe SiS dërgojnë kërkesën në ministritë e linjës dhe institucionet tjera, e cila përfshin listën e aktiviteteve, për të cilat është përgjegjës çdo institucion. Institucionet përgjegjëse, gjithashtu, do të ofrojnë informacion mbi problemet dhe rreziqet dhe mbi hapat e mundshëm të mëtejshëm për zgjidhjen e problemeve dhe një informacion mbi ekzekutimin e përgjithshëm të buxhetit. Informacioni i përfshirë në draft raport do të diskutohet dhe analizohet nga AQM dhe SiS dhe pas finalizimit, i raportohet Koordinatorit Nacional për Migrim.

Raporti vjetor do të përmbajë²⁰:

Përmbledhjen ekzekutive

Në këtë seksion do të jepen informata të shkurtra mbi progresin e çdo objekti strategjik të dokumentit strategjik, bazuar në indikatorët dhe në implementimin e reformave kyçe në këtë sektor. Në raport do të paraqiten vetëm arritjet në implemenimin e aktiviteteve më të rëndësishme. Rëndësia e aktiviteteve vendoset sipas fushëveprimit të ndikimit të tyre, vëmendjes politike dhe interesit të medias ose shoqërisë civile. Grafikët, tabelat dhe fotografitë do të përdoren për të ilustruar arritjet. Ky seksion, gjithashtu, do të ofroj informacion të shkurtër rreth progresit drejt arritjes së vizionit ("fotografia më e madhe"). Gjithashtu, ai përmbledh sfidat kryesore, rreziqet dhe masat e nevojshme korrigjuese. Ky seksion do të të përdoret për të udhëzuar vendimmarrësit, publikun dhe akterët tjerë

²⁰Doracak për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit.

[Http://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2019/02/MANUAL-P%C3%8BR-PLANIFIKIMIN-HARTIMIN-DHE-MONITORIMIN-E-DOKUMENTEVE-STRATEGJIKE-DHE-PLANEVE-T%C3%8B-TYRE-T%C3%8B-VEPRIMIT.pdf](http://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2019/02/MANUAL-P%C3%8BR-PLANIFIKIMIN-HARTIMIN-DHE-MONITORIMIN-E-DOKUMENTEVE-STRATEGJIKE-DHE-PLANEVE-T%C3%8B-TYRE-T%C3%8B-VEPRIMIT.pdf)

relevant. Përmbledhja ekzekutive do të jetë e shkurtër dhe koncize, e gjatë deri në tri faqe.

Progresi në implementimin e objektivave të dokumentit strategjik

Ky seksion do të përshkruan progresin e bërë drejt implementimit të secilit objektiv të dokumentit strategjik. Ai do të ketë aq nën-seksione sa ka objektiva në dokumentin strategjik. Para se të përshkruhet implementimi i secilit objektiv, këtu do të mund të jepen informata përmbledhëse mbi progresin e përgjithshëm. Ai mund të përfshijë informata mbi:

- reformat e implementuara me sukses gjatë vitit;
- fushat që kanë nevojë për përmirësim në implementim;
- ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit;
- Këtu mund të përdoren tabela dhe grafikë.

Progresi kundrejt objektivave: (titulli i objektivave)

Në këto nën-seksione do të ofrohen informatat për progresin e çdo objektivit strategjik të dokumentit. Progresi kundrejt secilit objektiv do të përshkruhet sipas treguesve dhe progresit të përgjithshëm në implementimin e aktiviteteve nën objektiv. Poashtu do të paraqitet informacioni nëse janë arritur caqet e treguesve si dhe një përshkrim i reformave kyçe të implementuara, dhe arsytet për çdo dështim në arritjen e objektivave. Ky informacion do të japë një ndjenjë nëse dokumenti strategjik po i afrohet arritjes së objektivave.


Çdo nën-seksion do të përfshijë informacionin e mëposhtëm:


- vlerësimin e arritjeve kryesore, duke përdorur tregues dhe grafikë;
- vlerësimin e sfidave dhe boshllëqeve;
- burimet buxhetore;
- konkluzionet dhe rekomandimet për hapat e ardhshëm.
- Grafikët, tabelat ose fotografitë do të përdoren për të ilustruar vlerësimin

Përmbajtja e raportit përfundimtar

Brenda tre (3) muajve nga përfundimi i afatit të fundit të implementimit të dokumenteve strategjike, Ministria e Punëve të Brendshme do të dorëzon një raport përfundimtar në ZPS, i cili përmban të njëjtat informata që kërkohen në raportin vjetor, një vlerësim nëse objektivat e dokumentit strategjik janë arritur përmes veprimeve të implementuara si dhe propozime për hapat e ardhshëm, nëse është e nevojshme, për realizimin e tyre. Raporti përfundimtar do të miratohet nga Ministri i Punëve të Brendshme dhe pastaj diskutohet me institucionet kryesore pjesëmarrëse dhe me ZPS, para se të dorëzohet në Komisionin për Planifikim Strategjik.

II. Vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm për themelimin e Grupit Punues për hartimin e Strategjisë së Migrimit 2021-2025





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs

Nr. 754/2020
 Datë: 11/092020

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme,
 Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, nxjerr:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi Punues për hartimin e Strategjise për Migrim dhe Planit të Veprimit 2021-2025.
2. Grupin Punues nga pika 1 e këtij vendimi e përbëjnë:
 - 2.1. Sefedin Kuçi, DSHAM/MPB, kryesues;
 - 2.2. Merita Vidishiçi, DIEKP/MPB, zv.kryesuese;
 - 2.3. Lulzim Fushtica, Kabineti i Ministrit/ MPB, anëtar;
 - 2.4. Valon Krasniçi, DSHAM/MPB, anëtar;
 - 2.5. Mergim Himaj, DL/MPB, anëtar;
 - 2.6. Naim Muja, Sekretariati per Strategji/ MPB, anëtar;
 - 2.7. Fahrije Ternava, DRPR/MPB, anëtare;
 - 2.8. Kushtrim Canolli, ZKM/ZPS, anëtar;
 - 2.9. Nehat Pllana, ZL/ZKM, anëtar;
 - 2.10. Rifat Limani, DRAPSH/MPB, anëtar;
 - 2.11. Njomza Musa Baholli, MPMS, anëtare;
 - 2.12. Avni Kastrati, ASRK, anëtar;
 - 2.13. Ferid Idrizi, MASHT, anëtar;
 - 2.14. Albana Morina, MSH, anëtare;
 - 2.15. Ylli Valla, MAPL, anëtar;
 - 2.16. Behar Isma, MPJD, anëtar;
 - 2.17. Kastriot Vrella, MTL, anëtar;
 - 2.18. Arta Maxhuni, MF, anëtare;
 - 2.19. Shkelzen Kuqi, MEA, anëtar;
 - 2.20. Rrahman Sylejmani, PK, anëtar;
 - 2.21. Ylleza Berisha, ZKM/Departamenti per Integrim Evropian, anëtare;
 - 2.22. Habibe Zeqiri, DSHAM/MPB, anëtare;
 - 2.23. Drita Xheladini, DBF/MPB, anëtare;
 - 2.24. Mirsada Voca, MPJD, anëtare;

III. Vlerësimi i Projektit të Binjakëzimit për Strategjinë për Migrim 2013-2019



RAPORTI I MISIONIT NGA EKSPERTËT AFATSHKURTËR		
Misioni		Fuqizimi i Institucioneve të Kosovës në Menaxhimin Efektiv të Migrimit
Numri i Projektit		KS 14 IB JH 04
Ekspertët		Z. Pawel Michniewicz (Poloni), Znj. Ilze Briede (Letoni)
Data e Misionit dhe Lokacioni		14-18maj 2018, Prishtinë, Kosovë
Komponenti	1	Legjislacioni dhe Strategjia e Migrimit
Aktiviteti	1.2.1(b)	Vlerësimi i Strategjisë Kombëtare për Migrimin 2013- 2018 dhe Plan Veprimi përkatës

Objektivat / Termat e Referencës

Qëllimi i aktivitetit ka qenë të vazhdohet dhe të përfundohet vlerësimi i Strategjisë Kombëtare dhe Plan Veprimi 2013-2018. Gjatë aktivitetit të mëparshëm (1.2.1 (a)) është propozuar metodologjia e vlerësimit dhe është zhvilluar një pyetësor që duhej shpërndarë tek të gjithë palët e interesit. Në total, DSHAM së bashku me disa palë interesi kanë plotësuar 33 pyetësorë që janë diskutuar gjatë aktivitetit gjë që ka sjellë konkluzionet dhe rekomandimet për vijueshmëri.

Gjatë aktivitetit janë organizuar disa takime me disa palë të interesit të ftuar nga zyrtarët e DSHAM. Në këto takime janë përfaqësuar institucione të tilla si DSHAM, Policia Shtetërore, Qendra e Mbajtjes, Ministria e Integritimit Evropian, Ministria e Diasporës, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Tregtisë dhe Investimeve. Disa nga pjesëmarrësit kanë qenë të përfshirë në hartimin

e Strategjisë së Migrimit, disa prej tyre janë pjesëtarë të Autoritetit Qeveritar të Migrimit (GAM) dhe janë pjesë e hartimit të Profilit të ri të Migrimit.

U organizua edhe një takim me Znj. Eva Kitzlet, KRB e projektit “Fuqizimi i Autoriteteve për Menaxhimin e Migrimit në Kosovë” (i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim [SDC] dhe i implementuar nga Qendra Ndërkombëtare për Zhvillim të Politikave të Migrimit [ICMPD]) me qëllim që të diskutohej mundësia e përfshirjes së disa ekspertëve të caktuar për projektin tjetër gjatë procesit të hartimit të Strategjisë së re të Migrimit. Është rënë dakord që kjo përfshirje mund të ishte e dobishme dhe mund të organizohej gjatë fazës fillestare të hartimit të strategjisë së re për të dhënë disa njohuri dhe informacione bazë në çështjet teorike lidhur me strategjitë e migrimit.

Vëzhgimet Kryesore

Plan Veprimi është miratuar në vitin 2013 dhe është rishqyrtuar në vitin 2015. Ky Plan Veprim ka tre objektiva strategjike:

1. Parandalimi i migrimit të parregullt dhe promovimi i migrimit të ligjshëm;
2. Përmirësimi i zhvillimit të ligjshëm dhe cirkular;
3. Transformimi dhe zhvillimi i migrimit në faktor ekonomik pozitiv.

Secili objektiv strategjik ka disa objektiva specifike dhe secili prej tyre duhet plotësuar nga një numër aktivitetesh përkatëse. Plan Veprimi përmban referenca për autoritetet përgjegjëse dhe palët e përfshira të interesit, kohëzgjatjen e planifikuar të aktiviteteve, burimin e financimit dhe indikatorët (rezultate sasiore apo cilësore).

Gjatë ndryshimeve në vitin 2015, mund të vërehen disa pasaktësi teknike dhe logjike në Plan (jo të gjithë numrat e vendosur në aktivitetet e përfshira në Plan janë të saktë – disa aktivitete të përfshira nuk u janë vendosur numrat, disa numra janë dyfishuar, gjë që do të komplikojë përbërjen e raportit të vlerësimit; disa aktivitete janë perifrastuar). Disa nga objektivat e reja nuk korrespondojnë me objektivat e përfshira në Strategji. Për shembull, objektivi i ri “Përmbushja e obligimeve që dalin nga përfshirja e Kosovës në Listën e Bardhë Shengen” nuk mund të përfshihet në asnjë nga objektivat specifike të parapara për implementimin e objektivit strategjik “Parandalimi i migrimit të parregullt dhe promovimi i migrimit të ligjshëm” prandaj baza ligjore për përfshirjen e këtyre objektivave të reja në Plan Veprim duhet të vihet në pikëpyetje.

Institucioni koordinues (DSHAM) supozojë të përgatiste raporte të progresit dy herë në vit, deri tani vetëm dy raporte janë nxjerrë – për vitet 2013-2015. Raporti për 2017 nuk është përgatitur pasi që aktiviteti 1.2.1 (a) brenda Projektit të Binjakëzimit ishte programuar në muajin qershor 2017 por është organizuar në muajin shtator 2017. Me qëllim që të mblidhen të dhënat, palëve të interesit u është kërkuar të dërgojnë të dhënat lidhur me progresin e arritur (lidhur me statistikat dhe aktivitetet e kryera). Raporti i fundit nuk i përmban të gjitha aktivitetet nga fillimi i implementimit të Plan Veprimi; ai përfaqëson vetëm disa nga zhvillimet më të fundit që janë zhvilluar gjatë vitit 2016. Siç është qartësuar gjatë diskutimeve, ka zhvillime që nuk janë përfshirë në ndonjë raport. Lidhur me disa aktivitete është përshkruar vetëm si “Që prej 2015, janë ndërmarrë aktivitete për të përmbushur këto objektiva dhe janë ende në vazhdimësi në përputhje me Planin Kohor”. Deklarata të tilla janë formale dhe nuk japin njohuri për situatën e vërtetë.

Disa aktivitete (1.1.1 për shembull) janë shënuar me fjalën “ka përfunduar” në raportin më të fundit të Progresit; megjithatë, nuk ka mekanizëm për të bërë vlerësimin nëse aktivitetet janë përfunduar plotësisht. Raportet i janë dorëzuar Zëvendës Ministrit të Punëve të Brendshme. Duhet theksuar që për të arritur transparencë më të mirë, raporti i ardhshëm duhet të konsolidohet dhe duhet të përfaqësojë të gjithë progresin e arritur si dhe evaluimin për statusin e implementimit të secilit aktivitet – a është implementuar aktiviteti, a është i implementuar pjesërisht apo nuk është implementuar fare.

Të dhënat e paraqitura për periudhën 2013-2015 nuk janë përfaqësuar për çdo vit; të dhënat janë paraqitur për periudhën e plotë gjë që pra e komplikon mundësinë për të vlerësuar progresin gjatë periudhës së referuar.

Me tu konsoliduar i gjithë progresi në raport, duhet të bëhet vlerësimi i rezultateve. Megjithëse Vendi Përfitues gjatë procesit të hartimit të Strategjisë është përpjekur që të bëjë zgjedhjen e indikatorëve të matshëm, një informacion bazë praktikisht mungon. Një përjashtim mund të përmendet – informacioni për marrëveshjet e nënshkruara për ripranim deri në 2012 është përfshirë në Strategji si dhe është shtuar edhe informacioni për marrëveshjet lidhur me përgatitjet. Kur të bëhet vlerësimi i progresit të arritur në aktivitetin Nr. 1.7.2 *Inicimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve për ripranim me vendet e origjinës apo vendet e treta të sigurta*, do të jetë e mundur të shihen sa marrëveshje të reja janë iniciuar dhe nënshkruar gjatë periudhës 2013-2018. Megjithatë, në shumicën e vendeve mungon informacioni bazë dhe nuk është e mundur të krahasohen rezultatet e arritura me situatën para se të aprovohej Strategjia. Për më tepër, indikatorët nuk përmbajnë ndonjë fokus (objektiv) – nuk përshkruhen as në Strategji as në Plan Veprim sesa marrëveshje ripranimi dhe me cilat vende do të iniciohen apo nënshkruhen, se sa fushata informacioni do të organizohen, se sa kontrole të detajuara kufitare duhet të kryhen etj.

Në vlerësimin e Strategjisë dhe Plan Veprimit duhet të vlerësohet edhe çështja buxhetore me qëllim që të përcaktohet nëse burimet financiare të caktuara për implementimin e aktiviteteve janë shpenzuar në mënyrën e duhur dhe nëse burimet që janë shpenzuar kanë dhënë rezultatet e synuara. Në këtë rast, nuk është e mundur një analizë e tillë pasi që Plan Veprimi në shumicën e rasteve tregon vetëm burimin financiar por jo shumën e burimeve të caktuara. Ka vetëm dy përjashtime ku është treguar shuma e burimeve financiare – aktiviteti nr. 1.1.2 *Organizimi i fushatave për informimin e qytetarëve për pasojat e migrimit të parregullt* (125 000 EUR) dhe aktiviteti nr. 1.10.4 *Avancimi dhe integrimi i DSHAM, SIVK dhe databazat SMR (BMS)* (740 000 EUR).

Gjatë aktivitetit 1.2.1 (a) që është zhvilluar në shtator 2017) një shtjelluar një pyetësor me qëllim që të mbështesë procesin e mbledhjes të të dhënave për Raportin e Progresit 2015-2017. Megjithatë, që me nisjen e Aktivitetit 1.2.1 (b), pyetësori është plotësuar vetëm për më pak se gjysmën e aktiviteteve të përfshira në Plan Veprim (28 nga 67 gjithsej).

Prandaj Ekspertët Afatshkurtër janë detyruar të mbledhin të dhëna gjatë aktivitetit, gjë që ka qenë një sfidë për shkak të kufizimeve kohore, për shkak të ndarjes së përgjegjësive lidhur me Plan Veprimin ndërmjet institucioneve dhe departamenteve të ndryshme qeveritare dhe për shkak të koordinimit të pamjaftueshëm brenda dhe ndërmjet institucioneve.

Pyetësorët e plotësuar, së bashku me informacionin dhe statistikat e mbledhura kanë shërbyer si bazë për shqyrtimin e Raportit të Progresit.

Duhet të theksohet që Ekspertët Afatshkurtër kanë identifikuar po ashtu disa kufizime të tjera për vlerësimin e gjendjes së implementimit të aktiviteteve të veçanta. Kufizimet kryesore janë si në vijim:

- Indikatorët jo gjithmonë korrespondojnë direkt me qëllimin e aktivitetit;
- Mungesë të dhënash për indikatorë të caktuar apo informacione shumë të përgjithshme dhe të pamjaftueshme;
- Më shumë se një institucion koordinues për disa aktivitete;
- Nuk ka informacion bazë dhe numrat që synohen të arrihen për indikatorët;
- Shumë aktivitete janë formuluar si vazhdimësi të hapave të ndërmarrë më parë;
- Qëllimi i disa aktiviteteve është dyfishuar;
- Mospërputhje ndërmjet versionit original dhe përkthimit në gjuhën angleze të Plan Veprimit (përfshirë numrat e objektivave dhe aktiviteteve).

Kufizimet e lartpërmendura kanë pasur ndikimin e tyre në vlerësimin e kryer nga Ekspertët Afatshkurtër. Duhet theksuar që as para dhe as gjatë Aktivitetit nuk ka qenë e mundur të pranohen të gjitha të dhënat e kërkuara me shkrim dhe prandaj disa nga të dhënat e paraqitura në dokumentin e bashkëngjitur bazohen në vlerësime të dhëna gojarisht nga zyrtarët e intervistuar. Të dhënat që duhen plotësuar apo verifikuar duhet të vihen në pah në Raportin e Progresit (19 raste).

Statusi i implementimit është vlerësuar nga Ekspertët Afatshkurtër në përputhje me njohuritë e tyre më të mira, megjithatë për shkak të arsyeve të lartpërmendura nuk mund të garantohet që vlerësimi paraqet një pasqyrim të plotë dhe gjithëpërfshirës të realitetit.

Rezultatet e vlerësimit janë si në vijim:

- 40 aktivitete (60%) janë implementuar (shumica e tyre është përkufizuar si “në vazhdimësi” gjë që ka kuptimin se implementimi nënkupton vazhdimësinë e veprimeve të iniciuara që më parë)
- 14 aktivitete (21%) janë implementuar në mënyrë të pjesshme.
- 11 aktivitete (16%) nuk janë implementuar.
- Në rastin e 2 aktiviteteve (3%) ka qenë e pamundur të vlerësohet niveli i implementimit për shkak të mungesës së të dhënave.

Në nëntor 2017 është krijuar grupi i ri punues nga Koordinatori Kombëtar për Strategjinë e Migrimit për hartimin e Strategjisë së re të Migrimit për periudhën e ardhshme.

Rekomandimet

Për shkak të faktit që 2018 është viti i fundit për Strategjinë Kombëtare të Migrimit dhe të Plan Veprimit, në këtë fazë nuk rekomandohet të bëhet ndonjë ndryshim-plotësim i madh strukturor në dokumentet e lartpërmendura me qëllim që të menaxhohet sa më mirë procesi i monitorimit dhe vlerësimit të Plan Veprimit.

Megjithatë, ka ende mundësi që të përmirësohet mekanizmi i monitorimit duke caktuar një kontakt person i cili do të koordinonte të gjitha aktivitetet e lidhura me Plan Veprimin brenda çdo Ministrie/institucioni të përfshirë, duke rritur rolin koordinues të Autoritetit Qeveritar të Migrimit (GAM) dhe duke përmirësuar shkëmbimin e informacionit brenda dhe ndërmjet institucioneve.

Të rishikohet Plan Veprimi, veçanërisht të sigurohet që çdo aktivitetet të mund të identifikohet nga numri i vet unik;

Për më tepër, kufizimet e identifikuar në këtë dokument duhet të merren parasysh gjatë procesit të hartimit të Strategjisë së re të Migrimit. Në veçanti:

- Objektivat duhet të përkufizohen me supozimin që implementimi i objektivit nënkupton progres në veçanti në fushën e [policy] politikës (jo vetëm vazhdimësia e veprimeve të filluara më parë);
- Indikatorët duhet të jenë të matshëm (institucioni përgjegjës duhet të këtë mundësi të japë të dhënat e duhura në bazë të rregullt) dhe duhet të pasqyrojnë në mënyrë direkte qëllimin e aktivitetit;
- Për zhvillimin e strategjisë së ardhshme, ndërkohë që krijohen indikatorët e matshëm është e nevojshme të jepen informacione bazë dhe numrat që synohen të arrihen. Është po ashtu e rëndësishme të konsultohen indikatorët e propozuar me qëllim që të sigurohet saktësia e tyre. Indikatorët duhet të fokusohen më shumë në rezultatet e pritura sesa në aktivitetet e kryera;
- Të sigurohet përputhshmëria e përgjithshme e Strategjisë Shtetërore dhe Plan Veprimi përkatës për të ardhmen. Objektivat strategjike dhe specifike janë specifikuar në Strategji prandaj ato duhet të pasqyrohen në Plan Veprim. Nëse është e nevojshme, ndryshimplotësimet duhet ti përmbahen objektivave strategjike të caktuara në Strategji apo edhe Strategjia duhet të ndryshohet/plotësohet;
- Të zhvillohet një mekanizëm gjithëpërfshirës për monitorimin e implementimit të Plan Veprimit:
 - Raportet duhet të përfshijnë informacione lidhur me **të gjitha** aktivitetet e planifikuara;
 - Të dhënat e mbledhura duhet të mundësojnë vlerësimin e nivelit të implementimit të të gjitha aktiviteteve (nëse janë të mjaftueshme masat e implementuar);
 - Në rast vonesash, duhet të jepen informacione shtesë lidhur me arsyet dhe zgjidhjet e mundshme;
 - Raportet duhet të hartohen në nivel punues dhe të aprovohen nga zyrtarë të lartë;
 - Gjatë periudhës monitoruese të Strategjisë së ardhshme të Migrimit mund të këshillohet organizimi i takimeve të rregullta të Autoritetit Qeveritar të Migrimit (GAM) për mbikëqyrjen e procesit të implementimit;
 - Raporti i progresit që pasqyron gjendjen e implementimit të Plan Veprimit duhet të dorëzohet të paktën një herë në vit.

Propozimet për aktivitetet e ardhshme brenda Projektit

- Vendi Përfitues do të fillojë të hartojë Strategjinë e re të Migrimit. Duhet të organizohen diskutime me palët e tjera të interesit me qëllim që të përkufizohen objektivat dhe afatet për fazat e ndryshme të hartimit të Strategjisë. Për më tepër, palëve të tjera të

interesit duhet ti jepet mjaft kohë për të bërë vlerësimin e prioriteteve të nevojshme që duhen përfshirë në Strategjinë e re të Migrimit;

- Është theksuar që aktivitetet e ardhshme mund të organizohen pasi të finalizohet Profili i Zgjeruar i Migrimit në gusht 2018. Aktivitetet e tjera mund të organizohen në shtator (teksti i Strategjisë së Migrimit) dhe në nëntor 2018 (Plan Veprimi);

- Të organizohet një punëtori brenda një projekti “Fuqizimi i Autoriteteve për Menaxhimin e Migrimit në Kosovë” ku të përfshihet eksperti/ekspertja të Qendrës Ndërkombëtare për Zhvillim të Politikave të Migrimit [ICMPD] për një trajnim lidhur me hartimin e dokumenteve strategjike. Trajnimi duhet të organizohet para aktivitetit 1.2.2 a.

Anekset: 1. Draft Raporti i Progresit i kryer nga Ekspertët Afatshkurtër për 2015 - 2017;

2. Prezantim lidhur me rezultatet gjatë aktivitetit 1.2.1 b.

Ekspertët afatshkurtër:

Pawel Michniewicz

Ilze Briede

IV. Korniza ligjore në fushën e migrimit

Korniza ligjore në fushën e migrimit është hartuar në përputhje me *acquis* të BE-së si pjesë e procesit të integritimit Evropian si dhe në bazë të kërkesave nga procesi për liberalizim të vizave me BE-në. Fusha e migrimit në Kosovë është e rregulluar me legjislacionin në vijim:

- **Ligji Nr.06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt** mes tjerash rregullon edhe çështjen e punësimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Me miratimin e Ligjit Nr.06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt është bërë inkorporimi i Ligjit për Dhënie e Lejës për Punë dhe Punësimin e Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës. Në kuadër të Ligjit të ri për të Huaj janë paraparënjë sërë ndryshimesh me qëllim të lehtësimit të procedurës për lëshimin e lejes së punës për të huajt, procedurën për urdhër largimin vullnetar dhe urdhër largimin me forcë dhe shqiptimin e gjobave për të huaj, poashtu është adresuar edhe çështja e trafikimit të të huajve në Republikën e Kosovës. Ky Ligj është harmonizuar me legjislacionin Evropian, respektivisht me Direktivën e Tretë të BE-së dhe Rregulloren e Parë të BE-së.
- **Ligji Nr. 06/L-026 për Azil**, është harmonizuar me Acquis të BE-së dhe përcaktimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të azilkërkuesve sipas direktivave të BE-së. Ligji i ri rregullon kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese, mbrojtjes së përkohshme, statusin, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, personave me status refugjati, si dhe personave të cilëve iu është lejuar mbrojtja plotësuese dhe mbrojtja e përkohshme. Ky Ligj është plotësuar/ ndryshuar me Ligjin nr. 06/L-026 për azil dhe i njëjti është publikuar në Gazetën Zyrtare në Maj 2018.
- **Ligji Nr.04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës** përcakton mënyrën e fitimit, humbjes dhe rifitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës dhe rregullon çështjet tjera të ndërlidhura me shtetësinë e Republikës së Kosovës.
- **Ligji Nr.03/L-208 për Ripranim**, përcakton rregullat dhe procedurat për ripranimin e një personi i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaji, i cili nuk përmbush ose nuk përmbush më, kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim në territorin e shtetit kërkues.
- **Ligji Nr.04/L-214 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L 072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror**, me qëllim të harmonizimit me *Acquis* të BE-së. Ndryshimet kryesore në ligjin e ri kanë të bëjnë kryesisht me përkufizimet dhe emërtimin e ligjit.
- **Ligji Nr.04/216 për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit**, rregullon bashkëpunimin ndërmjet të gjitha autoriteteve që janë të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe zbatimin e strategjive të përbashkëta të këtyre autoriteteve, në mënyrë që detyrat e parapara për këto autoritete dhe masat individuale që kanë

të bëjnë me parandalimin, zbulimin dhe hetimin e aktiviteteve të kundërligjshme penale, kontrollin, monitorimin dhe bashkëpunimin përkatës ndërkombëtar, të përmbushen në mënyrë të duhur, efikase dhe efektive.

- **Ligji Nr.04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit**, ka për qëllim parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz në të gjitha format e tij.
- **Ligji Nr.04/L-076 për Policinë** rregullon autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës.
- **Ligji Nr.04/L-003 për Gjendjen Civile** - ky ligj rregullon kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcaktimin e rregullave për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës.
- **Ligji Nr.02/L-121 për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin**, rregullon lajmërimin dhe ç'lajmërimin e vendbanimit dhe vendqëndrimit të qytetarëve, lajmërimin dhe ç'lajmërimin e mysafirrit, ndërrimin e adresës së banimit, kompetencat dhe mënyrën e mbajtjes së evidencave përkatëse.

Korniza ligjore ndërkombëtare në fushën e migrimit

Përveç dokumenteve të përgjithshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat kanë zbatim të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës, të parapara në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dokumentet kyçe të së drejtës ndërkombëtare në fushën e migrimit janë Konventa e OKB-së për të Drejtat e Migrantëve dhe Pjesëtarëve të Familjeve të tyre, si dhe Konventa e Gjenevës për Statusin e Refugjatit e vitit 1951.

Poashtu, në fushën e migrimit janë relevante politikat dhe iniciativat në nivel Evropian dhe Global sic është Pakti i BE-së për Migrimin dhe Azilin, Pakti Global për Migrimin dhe Pakti Global për Refugjatë.

Përvec tjerash, për kornizën ligjore vendore në fushën e migrimit janë relevante edhe ligjet e BE-së në këtë fushë:

- Direktiva e Këshillit Nr. 2003/86/EC e 22 Shtatorit 2003 për të drejtën e ribashkimit të familjes;
- Direktiva e Këshillit 2003/109/EC e 25 nëntorit 2003 lidhur me statusin e shtetit të tretështetasit të cilët janë banorë afatgjatë, e ndryshuar nga Direktiva 2011/51/EU;

- Direktiva e Këshillit 2009/50/EU e 25 Maj 2009 për kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të shteteve të treta me qëllim të punësimit me kualifikim të lartë (Direktiva Kartela e Kaltër e BE- së);
- Direktiva 2011/98/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 Dhjetorit 2011 për procedurë të vetme të aplikimit për leje të vetme për shtetasit e shteteve të treta për të qëndruar dhe punuar në territorin e një Shteti Anëtar dhe për një grup të përbashkët të të drejtat për punëtorët e shteteve të treta që banojnë legalisht në një Shtet Anëtar;
- Direktiva 2014/36/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 26 Shkurtit 2014 për kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të shteteve të treta me qëllim të punësimit si punëtorë sezonal;
- Direktiva 2014/66/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 15 Maj 2014 për kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të shteteve të treta në kuadrin e transferimit brenda korporatave;
- Direktiva (BE) 2016/801 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 Maj 2016 për kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të shteteve të treta për qëllime kërkimi, studime, trajnime, shërbim vullnetar, skema shkëmbimi të nxënësve ose projekte arsimore, dhe vendosje në familje (ndryshim i Direktivës 2004/114/EC për studentët de 2005/71/EC për kërkuesit);
- Rregullorja (BE) 2016/399 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 9 Marsit 2016 mbi një Kod të Bashkimit mbi rregullat që rregullojnë lëvizjen e personave përtej kufijve;
- Direktiva 2008/115/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 Dhjetorit 2008 për standardet dhe procedurat e përbashkëta në Shtetet Anëtare për kthimin e shtetasve të shteteve të treta që qëndrojnë ilegalisht;
- Vendimi i Këshillit 2004/573/KE i 29 Prill 2004 për organizimin e fluturimeve të bashkuar për largime nga territori i dy ose më shumë Shteteve Anëtare, të shtetasve të shteteve të treta që janë subjekt i urdhrave individualë të largimit;
- Direktiva 2004/81/KE për lejet e qëndrimit për viktimat e trafikimit;
- Direktiva 2009/52/KE për rregullimin e standardeve minimale për sanksione dhe masat ndaj punëdhënësve të shtetasve të shteteve të treta që qëndrojnë ilegalisht;
- Rregullorja (BE) 2019/1896 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 nëntor 2019 për Kufirit Evropian dhe Rojës Bregdetare dhe shfuqizimin e Rregulloreve (BE) Nr. 1052/2013 dhe (BE) 2016/1624.

V. Korniza e politikave

Republika e Kosovës ka hartuar politikat dhe dokumentet strategjike në fushën e migrimit, duke përfshirë ato që adresojnë menaxhimin e integruar të kufirit, parandalimin e migrimit të

parregullt, aspektet zhvillimoreqëndërlidhen me migrimin, rolin e diasporës, ripranimin, azilin dhe mbrojtjen ndërkombëtare, riintegrimin e personave të riatdhesuar, si dhe parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandimit me migrantë.

Strategjitë shtetërore dhe sektoriale që ndërlidhen me fushën e migrimit, janë:

- **Strategjia Nationale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2015-2019²¹**, është dokumenti kryesor nacional i politikave për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz. Strategjia ka për qëllim të avancojë koordinimin dhe harmonizimin e veprimeve ndër-institucionale, të intensifikojë ndjekjen ligjore dhe ndëshkimin e shkelësve të ligjit, si dhe të siguroj përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj viktimave të trafikimit.

- **Strategjia Kombëtare e Republikës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Plani i Veprimit 2020-2025** është dokumenti kryesor nacional i politikave për menaxhimin dhe kontrollin e kufirit shtetëror. Qëllimi i saj është kontrolli dhe mbikëqyrja efektive e kufirit shtetëror, bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet të gjitha autoriteteve kompetentetë përfshira në kontrollin e kufirit dhe lehtësimi i lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave, si dhe vendosja e një sistemi efikas dhe efektiv për menaxhimin e integruar të kufirit, në mënyrë që të arrihet qëllimi i përbashkët i kufijve të hapur dhe të sigurt.

- **Plani për Menaxhimin e Fluksit të mundshëm me migrantë, refugjatë dhe aplikues për mbrojtje ndërkombëtare** - ka për qëllim menaxhimin e fluksit të migrantëve, refugjatëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, duke definuar veprimet përgatitore dhe të reagimit në mënyrë të koordinuar nga institucionet e Republikës së Kosovës. Në plan janë të paraparë pesë skenarë të mundshëm, masat e reagimit për secilin skenarë, afatet kohore, si dhe kostoja për zbatimin e secilit aktivitet.

- **Strategjia kundër Krimit të Organizuar 2018-2022** - ka për qëllim adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me parandalimin, hetimin dhe denimin e personave të përfshirë në trafikimin e personave dhe kontrabandimin me migrantë.

- **Politikat e regjimit të vizave** - Republika e Kosovës ka vendosur regjimin e vizave me 88 vende, kryesisht të kontinentit të Azisë dhe kontinentit të Afrikës. Për më tepër, sistemi SIVK është shtrirë në 16 misione diplomatike dhe konsullore të Kosovës, nga ku lëshohen viza për qytetarët e këtyre shteteve.

VI. Mekanizmat institucional të përfshirë në fushën e migrimit

Institucionet vendore në fushën e migrimit

²¹Aktualisht është duke u hartuar Strategjia e re kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2021-2025

Migrimi si fushë është mjaft gjithëpërfshirëse dhe implikon angazhimin e një numri të konsiderueshëm të institucioneve, varësisht nga fushëveprimi i tyre në kuadër të këtij sektori, si për nga zhvillimi, ashtu edhe nga zbatimi i legjislacionit dhe politikave. Autoritetet kyçe që kanë përgjegjësi hartimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e politikave të migrimit në Republikën e Kosovës janë:

- **Koordinatori Nacional për Migrim (KNM)** - Koordinon, monitoron dhe raporton për zbatimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve të parapara në fushën e migrimit. Inicion dhe koordinon hartimin e politikave shtetërore në lidhje me migrimin; Adreson rekomandimet e propozuara nga Autoriteti Qeveritar për Migrim të institucionet përkatëse; Monitoron punën dhe funksionimin e Autoritetit Qeveritar për Migrim; Përfaqëson shtetin në iniciativa të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e migrimit.

- **Autoriteti Qeveritar për Migrim (AQM)** - organ ndër-institucional që përfshin të gjitha institucionet dhe agjencitë relevante të ndërlidhur direkt dhe indirekt në fushën e migrimit. Në mesin e shumë detyrave dhe përgjegjësive që ka, ofron këshilla për Koordinatorin Nacional për Migrim; harton Profilin e Migrimit; harton Strategjitë Shtetërore për Migrim dhe Planet e Veprimit; fron ekspertizë në fushën e migrimit për institucionet qeveritare gjatë procesit të hartimit të politikave sektoriale; vlerëson nivelin e zbatimit të politikave në fushën e migrimit;

- **Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)** - si institucion kyç në këtë fushë, është përgjegjës për politikën e migrimit, përfshirë lidhjen e marrëveshjeve bilaterale për ri-pranim, kryesisht përmes **DSHAM-it**, i cili departament mes tjerash, vendos mbi kërkesat për shtetësi, leje-qëndrim, azil, mbrojtje ndërkombëtare, e ri-pranim, si dhe ka nën mbikëqyrje Qendrën e Mbajtjes për të Huaj dhe Qendrën e Azil-kërkuesve. Një tjetër aspekt të rëndësishëm që MPB trajton në këtë fushë është ri-integrimi i personave të riatdhesuar, nëpërmjet programeve të ri-integrimit të cilat hartohen, zbatohen dhe monitorohen nga **Departamenti për Ri-integrimin** e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve dhe Qendrën për Akomodimin e Përkohshëm të Personave të Riatdhesuar, në bashkëpunim me institucionet relevante të linjës si dhe koordinimin e politikave për integrimin e të huajve me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Kosovës. Poashtu, si agjenci ekzekutive në kuadër të MPB-së, **Policia e Kosovës** është përgjegjëse për kontrollin dhe mbikëqyrjen e lëvizjeve migratore në pikat e kalimit të kufirit dhe në brendi të territorit; monitorimi i të huajve me qëndrim të parregullt, hetimi dhe ndëjkja e personave të dyshuar për kontrabandim me migrantë dhe trafikim me qenie njerëzore etj.

- **Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD)** - zhvillon dhe bashkërendon politikën në punët e jashtme, duke shpreh dhe mbrojt interesat e Kosovës në raport me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, në bashkërendim të plotë me ministrinë e tjera, ndërsa veprimtaria e këtij institucioni në fushën e migrimit përfshin, nënshkrimin e marrëveshjeve në kuadër të kësaj fushe (p.sh. marrëveshjet bilaterale për ripranim), nxjerrjen e udhëzimeve për Sistemin Informativ të Vizave të Kosovës (SIVK), udhëzimeve për procedurat e lëshimit të vizave në

misionet diplomatike/konsullore dhe pikat kufitare, formën dhe përmbajtjen e Afishes së Vizës si dhe vendimin mbi lëshimin e vizave, përmes Misioneve Diplomatike/Konsullore të Republikës së Kosovës, për qytetaret e vendeve për të cilat Kosova aplikon regjimin e vizave.

- **Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)** –Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është autoriteti kompetent që bën vlerësimet mbi implikimet financiare sa i përket politikave të migrimit dhe zbatimit të tyre. Poashtu, MFPT është përgjegjëse për hartimin e politikave të punësimit dhe të aftësimin profesional, ndërsa Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës APRK²² organizon dhe koordinon planifikimin vjetor të aktiviteteve dhe iniciativave për implementim të politikave vjetore të punësimit dhe të aftësimin profesional të hartuara nga MFPT-ja. Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, lëshon Leje afatshkurte për Shtetasit e Huaj, deri në 90 ditë brenda 180 ditëve bazuar në Ligji Nr.06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt.
- **Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MSHTI)**- aktivitetet e kësaj ministrie që lidhen drejtpërdrejt me fushën e migrimi janë ofrimi i shërbimeve për ri-integrimin e personave të riatdhesuar në sistemin shkollor. MASH poashtu është përgjegjës për regjistrimin e të huajve në sistemin arsimor të Kosovës si dhe zbatimin e programeve për mobilitetin e studentëve kosovarë.
- **Ministria e Ekonomisë (ME)**– në përgjithësi zhvillon dhe zbaton politika të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthortë ndikojnë në trendet e migrimit në vend, duke e pasur parasysh që zhvillimi ekonomik trajtohet si një nga elementet më kryesore të lëvizjeve migratore.
- **Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë (MINT)** - përmes Agjencisë për Përkrahjen e Investimeve dhe Ndërmarrjeve (KIESA) zbaton programe që kanë për qëllim trajtimin e veçantë të investitorëve nga Diaspora si dhe promovimin e investimeve, eksportit dhe turizmit me fokus në vendet ku Diaspora kosovare është e koncentruar.
- **Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)** - mbledh, analizon dhe ofron statistika lidhur me lëvizjet migratore, përfshirë edhe migrimin e brendshëm.
- **Banka Qendrore e Kosovës (BQK)** - mbledh, analizon dhe ofron statistika relevante në fushën e migrimit përkatsisht të dhëna lidhur me remitencat, investimet e huaja direkte, shërbimet e udhëtimit të Diasporës (vizitorët nga Diaspora).

²²<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8983>

Organizatat dhe akterët e shoqërisë civile në fushën e migrimit

Një numër i organizatave vendore të shoqërisë civile janë të përfshira aktivisht në përkrahjen e zbatimit të legjislacionit dhe politikave në këtë fushë nëpërmjet projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme. Akterët kryesor të shoqërisë civile të përfshirë në këtë fushë janë:

- Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP-K);
- Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRVT)

VII. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e migrimit

Institucionet e Republikës së Kosovës kanë zhvilluar forma të ndryshme të bashkëpunimit me organizata dhe iniciativa të veçanta ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e migrimit. Kosova gjithashtu ka vendosur bashkëpunim bilateral në fushën e migrimit me një numër të konsideruar të shteteve të cilat konsiderohen me interes.

Bashkëpunimi me organizatat dhe iniciativat rajonale dhe ndërkombëtare, dhe aktorët e tjerë ndërkombëtarë në fushën e migrimit

Akterët kryesorë të kësaj kategorie të përfshirë në fushën e migrimit janë:

- Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM);
- Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë;
- Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR);
- Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ);
- Qendra Ndërkombëtare për Përgatitjen e Politikave të Migrimit (ICMPD);
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF);
- Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBE);
- Nisma Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI);
- Këshilli Danez për Refugjatë (DRC);
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Misioni në Kosovë;
- CARITAS Zvicran.

Në lidhje me bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në iniciativat ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e migrimit, gjatë kësaj periudhe Republika e Kosovës ka marrë pjesë vazhdimisht në aktivitetet në kuadër të Procesit të Pragës, si në takimin e zyrtarëve të lartë ashtu edhe në trajnime.

Po ashtu, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të Autoritetit Qeveritar për Migrim dhe për të mbështetur Koordinatorin Kombëtar për Migrim, MPB është mbështetur nga Programi Global i GIZ dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, në kuadër të Marrëveshjes së Partneritetit për Migrim në mes të Kosovës dhe Zvicrës, aktivitetet e së cilit projekt kanë përfshirë

trajnime tematike të ndryshme, zhvillimin e hulumtimit për migrimin, si dhe organizimin e fushatës për informimin e qytetarëve mbi rregullat e lëvizjes pa viza në Zonën Schengen.

Bashkëpunimi bilateral në fushën e migrimit

Deri më tani, Republika e Kosovës ka nënshkruar 22 marrëveshje me 24 shtete në fushën e ripranimit. Gjithashtu Republika e Kosovës që nga viti 2009 ka në fuqi Ligjin për Ripranim, i cili ka përparësi në aspektin e bashkëpunimit për ripranimin me vendet me të cilat Kosova ende nuk ka nënshkruar një marrëveshje dypalëshe për ripranim.

Takime të rregullta organizohen me atashetë e migrimit në Misionet Diplomatike dhe Konsullore të akredituara në Kosovë, me qëllim të shkëmbimit të të dhënave dhe diskutimit rreth sfidave në fushën e azilit dhe migrimit.